



**Raporti i Monitorimit
të Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje
dhe Planit të veprimit 2011-2014,
Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit Kundër
Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014 dhe
Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje
nga shoqëria civile**

Dhjetor 2012

Prishtinë, Kosovë

Ky raport monitorimi është përkrahur nga Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas (WSSI Plus) e Programit për Zhvillim të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme e Holandës. Qëndrimet e paraqitura në këtë raport nuk përbëjnë domosdoshmërisht qëndrime të UNDP-së.



Kingdom of the Netherlands



Empowered lives.
Resilient nations.

Përmbajtja

Përmbajtja.....	3
Falënderim.....	5
Lista e shkurtesave	6
Përmbledhje e përgjithshme.....	8
I. Hyrje	9
1. Përkufizimet	11
1.1. Dhuna në familje	11
1.2. Trafikimi me qenie njerëzore.....	11
1.3. Metodologjia e hulumtimit	12
1.4. Qëllimi i hulumtimit.....	12
1.5. Objektivat e hulumtimit.....	13
1.6. Kufizimet e hulumtimit.....	13
1.7. Struktura e raportit	14
II. Situata e përgjithshme socio-ekonomike e vendit në kontekstin e luftimit të fenomeneve “Dhuna në familje” dhe “Trafikimi me Qenie Njerëzore”	15
2.1. Korniza ligjore e Kosovës mbi dhunën në familje dhe trafikimin e qenieve njerëzore ..	17
2.2. Misioni, Vizioni dhe Qëllimi i PKKDHf-PV 2011-2014 dhe SNKTQNj-PV 2011-2014 ..	19
2.3. Objektivat specifike të PKKDHf-PV 2011-2014	21
2.3.1. Objektivi specifik 1	21
2.3.2. Objektivi specifik 2	21
2.3.3. Objektivi specifik 3	21
2.4. Objektivat specifike të SNKTQNj-PV 2011-2014	22
2.4.1. Parandalimi.....	22
2.4.2. Mbrojtja dhe ndihma e viktimave dhe dëshmitarëve.....	23
2.4.3. Hetimi dhe ndëshkimi i krimeve të trafikimit.....	23
III. Përparimi në implementimin e Programit të Kosovës dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje (PKKDHf-PV 2011-2014) në nivelin qendror dhe lokal.....	25
3.1. Parandalimi.....	25
3.1.1. Agjencioni për Barazi Gjinore.....	26
3.1.2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	27
3.1.3. Mediat.....	28
3.2. Mbrojtja dhe siguria.....	29
3.2.1. Prokuroria e shtetit - Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave	29

3.2.2.	Policia e Kosovës	31
3.3.	Përkrahja, trajtimi dhe reintegrimi.....	38
3.3.1.	Ministria e Shëndetsisë	38
3.3.2.	Strehimoret	39
3.3.3.	Qendra për Punë Sociale.....	45
3.3.4.	Gjyqësori	46
IV.	Përparimi në implementimin e Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014 në nivelin qendror dhe lokal.....	48
4.1.	Plani i veprimit	50
4.1.1.	Parandalimi i trafikimit.....	50
4.1.2.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	50
4.2.	Mbrojtja dhe ndihma e viktimave dhe dëshmitarëve	51
4.2.1.	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)	51
4.2.2.	Strehimorja	54
4.2.3.	Ministria e Shëndetësisë	55
4.3.	Hetimi, arrestimi dhe ndëshkimi i krimeve të trafikimit	55
4.3.1.	Policia e Kosovës	56
4.3.2.	Prokuroria e Shtetit	57
4.3.3.	Gjyqësori	58
4.4.	Mbrojtja e fëmijëve	58
V.	Përfundimi	60
VI.	Rekomandime.....	62
Shtojca nr. 1	Lista e institucioneve dhe personave të kontaktuar apo intervistuar për grumbullim të të dhënave për raportin e monitorimit:	66
Shtojca nr. 2:	Plani i Veprimit SNKTQNJ 2011-2014	69
Shtojca nr. 3:	Plani i Veprimit PKKDHF 2011-2014	90

Falënderim

OJQ-të e përfshira në monitorimin e **Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të veprimit 2011-2014, Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje** u shprehin mirënjohje përfaqësuesve të institucioneve të Kosovës, organizatave joqeveritare-OJQ-të, **MDA-së** (Management Development Associates) dhe donatorëve që kontribuan në realizimin e këtij hulumtimi. Në kuadër të këtij hulumtimi janë kontaktuar shumë institucione qeveritare të nivelit qendror dhe lokal, ndër to janë: Agjencia për Barazi Gjinore (ABGJ), Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Drejtësisë (MD), Prokuroria e Shtetit (PSH), Policia e Kosovës (PK), Mbrojtësit e Viktimave (MV), Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës (KSK), Këshilli Gyqësor i Kosovës (KGjK), Gjykatat Komunale (GjK), Gjykatat e Qarkut (GjQ), dhe drejtoritë komunale të Drejtoria Komunale për Arsim (DKA), Drejtoria për Shëndetësi (DSH), Drejtoria për Punë dhe Mirëqenie Sociale (DPMS), Qendrat për Punë Sociale (QPS), Qendrat Komunale të Mjeksisë Familjare (QKMF) në pothuajse të gjitha komunat e Kosovës, OJQ-Qendra për ndihmë juridike dhe zhvillim regjional (CLARD), Mediat (RTK, KTV, RTV21, Koha Ditore, Radio Kosova, etj) dhe Qendrat për strehimin e viktimave të dhunës në baza gjinore. Kërkojmë ndjesë nëse kemi harruar të përmendim ndonjë institucion apo organizatë e cila ka kontribuar në hartim të këtij raporti. Ky hulumtim nuk do të mund të realizohej pa ndihmën e tyre.

Posaqërisht falënderojmë Iniciativën për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas (WSSI Plus) të Programit për Zhvillim të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP) për financimin e këtij projekti.

Gjithashtu falënderojmë kompaninë Management and Development Associates (MDA) për trajnimin tonë dhe përzgjedhjen tonë për të hartuar këtë raport vjetor për vitin 2011. Në kuadër të ekipit hulumtues dhe hartuesve të këtij raporti, OJQ-të me përkushtim kaluan orë të shumta duke lexuar, diskutuar, shkruar dhe kontrolluar faktet relevante; anëtarët e këtyre OJQ-ve janë: OJQ “CBM” Mitrovicë/Mitrovica, OJQ “ZANA” Klinë/Klina, OJQ “Shtëpia e Sigurtë” Gjakovë/Djakovica, OJQ “Qendra e Gruas Prehja” Skënderaj/Srbica, OJQ “MEDIKA BL” Prishtinë/Priština, OJQ “LULEBORA” Prishtinë/Priština, OJQ “Për Mendje të Shëndoshë” Prizren/Prizren, OJQ “Gruaja Familjare” Prizren/Prizren dhe OJQ “Fortesa” Kamenicë/Kamenica.

Lista e shkurtesave

ABGJ	Agjencia për Barazi Gjinore
DKA	Drejtoria Komunale për Arsim
DMNV	Divizioni për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave
DMS	Departamenti për Mirëqenie Sociale
DPP	Departamenti i Punës dhe Punësimit
DSHPS	Drejtoria për Shëndetësi dhe Punë Sociale
DHTQNJ	Drejtoria e Hetuesisë së Trafikimit me Qenie Njerëzore
ESK	Enti Statistikor i Kosovës
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MD	Ministria e Drejtësisë
MDA	Management and Development Associates
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MV	Mbrojtës i viktimave
MVPT	Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit
NHDHF	Njësia e Hetimeve për Dhunë në Familje
OJQ	Organizatë Jo-qeveritare
PKKDHf-PV	Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit
PKKT	Programi i Kosovës Kundër Trafikimit
QMG	Qendra për Mirëqenien e Grave
QMGF	Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve

QPS	Qendra për Punë Sociale
QPS	Qendra për Punë Sociale
QRP	Qendra Rajonale për Punësim
QSGF	Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve
RGGK	Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës
SDSF	Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve – Kosovë
SNKTQNJ-PV	Strategjia Nacionale kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit
UM	Urdhër Mbrojtës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
WSSI Plus	Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas
ZBGJ	Zyrtare për Barazi Gjinore
ZMNV	Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave

Përmbledhje e përgjithshme

Dhuna në familje si dukuri negative është tejet prezente në familjet kosovare, përkundër ekzistimit të legjislacionit për mbrojtje nga kjo dukuri, ajo vazhdon të mbetet fenomen prezent në shoqërinë tonë. Pasojat e dhunës në familje janë të dëmshme jo vetëm për individin apo për një familje, por ato janë të përmasave të gjëra shoqërore e sociale.

Duke u bazuar në këtë fakt, për të luftuar e parandaluar këtë dukuri, institucionet shtetërore kanë marrë hapa konkret duke punuar dhe nxjerrur edhe strategji kombëtare. Që nga viti 2000, institucionet kanë punuar strategji për të luftuar dukuritë negative që kanë dëmtuar shoqërinë kosovare dhe njerëzimin në përgjithësi.

Strategjia e fundit që është punuar për këtë qëllim është “Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit 2011-2014-PKKDHF-PV” .

Jo më pak shqetësuese është edhe prezenca e dukurisë tjetër të rëndë, trafikimi i qenieve njerëzore, dukuri kjo që pas konfliktit të vitit 1999, në Kosovë, ka zënë vend shqetësues dhe ka detyruar institucionet që të merren seriozisht me këtë problematikë. Edhe për luftimin e kësaj dukurie në muajin maj të vitit 2011 është rishikuar “Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2008-2011” dhe është hartuar “Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014”.

Rezultatet e monitorimit të implementimit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe implementimit të strategjive në fjalë do të na ndihmojnë për të ecur më sigurt drejt luftimit të këtyre dukurive dhe për të çrrënjësuar ato nga shoqëria kosovare. Mirëpo, fakti i ekzistimit të ligjit dhe strategjive, nuk mund të ketë efektin e plotë e pozitiv nëse nuk implementohen si duhet dhe nëse nuk analizohen e përshtaten konform rrethanave e rrjedhave aktuale.

Për të analizuar më konkretisht këtë çështje, kemi marrë si obligim të bëjmë vlerësimin e implementimit të “Ligjit për mbrojtje nga Dhuna në Familje” dhe strategjive të lartshënuara. Ligji për mbrojtje nga Dhuna në Familje është monitoruar në kuadër të monitorimit të PKKDHF-PV.

I. Hyrje

Këshilli i Evropës vlerëson se dhuna në familje është shkaktari kryesor i vdekjes dhe paaftësismit të grave të moshës mes 16 dhe 44 vjeç në Evropë.¹

Në Kosovë, dhuna në familje përbën formën më të përhapur të dhunës në baza gjinore.² Strategjia e aprovuar rishtas në vitin 2011 “Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plan i veprimit 2011-2014” obligon institucione, agjenci e organizata të tjera të parandalojnë dhunën në familje, të mbrojnë viktimat, të ndjekin autorët e dhunës dhe të kryejnë rehabilitimin e viktimave, autorëve të dhunës dhe fëmijëve të tyre.³

Shërbime gjegjëse ofrohen nga institucione të ndryshme, përfshirë mes tjerash njësitë e specializuara të policisë, mbrojtësit e viktimave të cilët mbrojnë të drejtat e këtyre të fundit, zyrtarët që ofrojnë ndihmë juridike, qendrat për punë sociale, strehimoret etj.

Miratimi i Ligjit për Mbrojtje Kundër Dhunës në Familje në Kosovë në korrik të vitit 2010 dhe i Programit të Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit në Kosovë për periudhën 2011-2014 përbëjnë hapa të rëndësishëm në këtë drejtim. Ekzistimi i kësaj baze ligjore dhe planit të veprimit nuk siguron zbatim të përpiktë të tyre. Në këtë drejtim, monitorimi me të cilin sigurohet implementimi efektiv dhe efikas i kësaj kornize ligjore është i domosdoshëm.

Trafikimi i qenieve njerëzore është krim njerëzor dhe paraqet shkelje të të drejtave të njeriut; trafikimi zhvillohet përmes rrjeteve të krimit të organizuar apo individualisht. Autorët e këtij krimi luajnë një shumëllojshmëri të roleve duke kryer akte të ndryshme të paligjshme brenda apo jashtë territorit të një vendi. Krimi i trafikimit të qenieve njerëzore është i ndarë në kategori të ndryshme në varësi të qëllimit të shfrytëzimit⁴.

Në Republikën e Kosovës grupet më të rrezikuara për trafikimin e personave janë gratë dhe fëmijët që shfrytëzohen për qëllime seksuale (prostitucion i detyruar). Bazuar në raportin e Policisë së Kosovës, gjatë vitit 2011 në Kosovë janë raportuar 39 viktima të trafikimit. Nga ky numër 35 janë shtetase të Kosovës. Shumica e viktimave që vijnë nga vendet e lindjes janë të detyruar të emigrojnë jashtë vendit si rezultat i nivelit të lartë të varfërisë në vendin e tyre të origjinës në kërkim të punësimit dhe një jetë më të mirë. Megjithatë në bazë të raportit të Policisë së Kosovës (PK), në Kosovë numri më i madh i viktimave të trafikimit janë shtetas të Kosovës.

¹ Këshilli i Evropës, Asambleja Parlamentare “Dhuna ndaj gruas në familje”, rekomandimi 1582, 2002.

² Publikimi i RRGK-se, Siguria fillon në shtëpi; Hulumtimi për Qëllime Strategjike së parë Kombëtare dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje në Kosovë, Prishtinë: Agjencia për Barazi Gjinore

³ Raporti Rajonal i Gjilanit 2012

⁴ SNKTQNJ-PV 2011-2014, II.2

Kjo situatë shfrytëzohet nga trafikantët për t'i mashtruar viktimat me premtimet për një jetë më të mirë dhe punësim të ligjshëm në vendin e destinacionit. Forma kryesore e shfrytëzimit të viktimave mbetet ai i shfrytëzimit seksual/prostitucion i detyruar nëpër lokalet të cilat operojnë në mënyrë të paligjshme anekënd vendit. Numri i lokaleve të tilla të mbyllura gjatë vitit 2011 në Kosovë e dëshmon këtë fakt.⁵

Miratimi para pak kohe i Strategjisë Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Planit të Veprimit në Kosovë (në tekstin e mëtejme “SNKTQNJ-PV 2011-2014”) për periudhën 2011-2014 si dhe Kodi Penal i Kosovës dhe legjislacioni mbështetës përbëjnë bazën ligjore dhe planin për parandalimin, mbrojtjen dhe reintegrimin e viktimave, si dhe ndëshkimin e trafikantëve. Tani, është i domosdoshëm monitorimi me të cilin sigurohet implementim efektiv dhe efikas i kësaj strategjie.

Shoqëria civile si agjent joshtetëror luan rolin e saj si katalizator dhe monitorues i zbatimit të përpiktë të objektivave të kësaj strategjie, duke e shikuar zbatimin apo ngecjen nga një këndvështrim tjetër. Qëllimi i këtij hulumtimi është të nxjerrim në pah në mënyrë të përgjithësuar se çfarë është realizuar në vitin 2011 nga objektivat specifike të SNKTQNJ-PV 2011-2014 si dhe PKKDFH-PV 2011-2014. Koha tejet e shkurtër në dispozicion ishte pengesë për grumbullimin e të gjitha informacioneve të nevojshme për të përgaditur një raport më të detajuar për secilën objektivë konkrete. Strategjitë hartohen për tu zbatuar në përpikmëri, prandaj një monitorim dhe vlerësim nga një agjent i paanshëm, në këtë rast shoqëria civile, është mëse e domosdoshme për të prezentuar një gjendje reale se çfarë është bërë dhe çfarë nuk është bërë gjatë periudhës së caktuar kohore.

⁵ Raporti i Policisë – Departamenti i Hetimit të trafikimit të Qenieve Njerëzore, tetor 2012

1. Përkufizimet

1.1. Dhuna në familje

Dhunë në familje - një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në:⁶

- përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes;
- çdo veprim tjetër i një anëtari të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike;
- shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;
- sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;
- ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;
- përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër;
- marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;
- kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;
- dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;
- vënja e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike;
- hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër;
- rrëmbimi.

1.2. Trafikimi me qenie njerëzore

Sipas legjislacionit në fuqi⁷, trafikimi i personave përkufizohet si rekrutim, transferim, strehim ose pranim të personave, përmes kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të detyrimit, të abuzimit, të mashtrimit, të gënimit, ose abuzimit të pushtetit, ose pozitës së vështirë, ose përbërjen apo pranimin e pagesave apo përfitimeve të tjera, për të marrë pëlqimin e personit që ka kontroll mbi një person tjetër, me qëllim të shfrytëzimit. Baza ligjore e legjislacionit vendor, mbështetet në një sërë dokumentash dhe konventash ndërkombëtare.

⁶ Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 03/L-182

⁷ Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës, neni 139

1.3. Metodologjia e hulumtimit

Ideja për realizim të këtij hulumtimi ka lindur falë projektit të financuar nga UNDP, projekti Iniciativa për Mbrojtjen dhe Sigurinë e Gruas (WSSI plus) në Kosovë. Në kuadër të projektit “Trajnimi i shoqërisë civile për monitorim dhe evaluim të PKKDHF-PV 2011-2014 dhe SNKTQNJ-PV 2011-2014” është krijuar një rrjet jo formal i përbërë nga stafi i OJQ-ve të cilat participuan në trajnime dhe u përzgjedhën nga trajnerët për të kryer hulumtimin dhe pastaj për të hartuar raportin vjetor. Ky Rrjet u organizua në pesë grupe për të realizuar hulumtimin në bazë rajonale duke i përfshirë 5 rajonet e Kosovës (Prishtinë/Priština, Mitrovicë/Mitrovica, Pejë/Peć, Prizren/Prizren, Gjiilan/Gnjilane). Pas hulumtimit, materiali i grumbulluar është klasifikuar dhe përmbledhur në një raport të përgjithshëm vjetor. Hulumtimi është realizuar bazuar në grumbullimin e të dhënave nga raportet, statistikën, intervistat me personat kompetent: zëdhënës, udhëheqës departamentesh, etj *(për më tepër shih shtojcën nr. 1: Lista e personave të intervistuar, kontaktuar)* të institucioneve relevante. Është realizuar një numër i madh i takimeve individuale me persona përgjegjës të secilit institucion apo organizatë, gjithashtu janë dërguar kërkesa me shkrim të dëguara me postë, në mënyrë elektronike apo të dorëzuara personalisht në institucionin gjegjës. Për të arritur deri në hartimin final të këtij raporti, fillimisht është realizuar një hulumtim primar i materialeve të shtypura, ligjeve, rregulloreve, analizave, raporteve paraprake, lidhur me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Strategjisë Nacionale si dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014 si dhe Programit të Kosovës dhe Planit të Veprimit për luftimin e Dhunës në Familje 2011-2014.

1.4. Qëllimi i hulumtimit

Ky vlerësim është kryer për të analizuar zbatimin e **Programit të Kosovës dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje 2011-2014, Strategjisë Nacionale kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2011 -2014 si dhe për monitorimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje gjatë vitin 2011.**

Qëllimi i hulumtimit nga rrjeti i shoqërisë civile është monitorimi i institucioneve shtetërore dhe angazhimit të tyre në lidhje me zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, SNKTQNJ-PV 2011-2014 dhe PKKDHF-PV 2011-2014. Respektivisht është grumbulluar informacioni nga akterët kryesorë të përfshirë në zbatimin e objektivave për veprimet e tyre konkrete përkitazi me objektivat e planifikuara të realizohen brenda vitit 2011.

Ne jemi munduar të hartojmë një raport ku përfshihen të gjithë akterët të cilët kanë eksperiencë në luftën kundër dhunës në familje dhe kundër trafikimit me qenie njerëzore. Ne u jemi mirënjohës të gjithë atyre që ndihmuan në këtë rrugë.

1.5. Objektivat e hulumtimit

Ndër objektivat e hulumtimit janë:

- Identifikimi i nivelit të bashkëpunimit dhe koordinimit të akterëve kryesorë për implementimin e të dy strategjive dhe Ligjit.
- Vetëdijësimi i publikut për ekzistimin e fenomenit “dhunë në familje” dhe “trafikim me qenie njerëzore” dhe vetëdijësimi i tyre për ekzistimin e dy strategjive nacionale për luftimin e këtyre fenomeneve.
- Identifikimi i nivelit të aplikimit të ligjit dhe strategjive në nivelin lokal.
- Niveli i realizimit të objektivave të strategjive gjegjëse, etj.

1.6. Kufizimet e hulumtimit

Kufizim kryesor në hulumtimin dhe draftimin e këtij raporti ka qenë afati tejet i shkurtë kohor për realizim të hulumtimit dhe draftim të raportit. Duke marrë parasysh që shumica e institucioneve të kontaktuara, kanë kërkuar kërkesë zyrtare dhe zbatim të afatit ligjor prej 14 ditësh për përpunim të kërkesës dhe kthim të përgjigjes, shumë informacione ka qenë e pamundur të sigurohen brenda afatit 10 ditor sa kishte në dispozicion secila ekipë punuese. Është tejet brengosës fakti që institucionet tona shtetërore funksionojnë pa një databazë të mirëfilltë të të dhënave. Të dhënat në këto institucione ende mbahen në fletore dhe libra jo zyrtar apo në raste më të mira në programe word dhe excel, të cilat shpeshherë zyrtarët nuk mund t'i gjejnë se ku i kanë ruajtur. Prandaj, shumica e informacioneve të cilat mungojnë në këtë raport nuk janë siguruar si pasojë e faktorit kohë dhe mosekzistimit të një softueri të sofistikuar - databazë. Kjo mungesë e të dhënave na ka pamundësuar të bëjmë një analizë të thellë të të dhënave dhe të bëjmë krahasime në mes të dhënave të pranuar nga akterët e ndryshëm psh: Policia dhe Gjykatat apo Prokuroria. Të gjitha informacionet e siguruar mbulojnë vetëm periudhën janar-dhjetor 2011. Në kuadër të këtij hulumtimi nuk janë përfshirë komunat në veri të Kosovës : Leposaviç-Leposavić, Zvečan-Zvečan dhe Zubin Potok për shkak të situatës jo të qëndrueshme në këtë pjesë të territorit të vendit.

1.7. Struktura e raportit

Ky raport përbëhet nga 6 kapituj:

- Kapitulli I:** Kapitulli i parë do të përfshijë hyrjen, metodologjinë e hulumtimit si dhe objektivat dhe kufizimet e hulumtimit.
- Kapitulli II:** Kapitulli i dytë do të trajtoj situatën e përgjithshme në vendin tonë në kontekstin e luftimit të fenomeneve “Dhuna në familje” dhe “Trafikimi me Qenie Njerëzore”.
- Kapitulli III:** Ky kapitull do të përfshijë të dhënat e grumbulluara për zbatimin e objektivave të Programit të Kosovës dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje 2011-2014.
- Kapitulli IV:** Ky kapitull do të përfshijë të dhënat e grumbulluara për zbatimin e objektivave të Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014 në nivelin qendror dhe lokal.
- Kapitulli V:** Përfundimi.
- Kapitulli VI:** Rekomandimet.

II. Situata e përgjithshme socio-ekonomike e vendit në kontekstin e luftimit të fenomeneve “Dhuna në familje” dhe “Trafikimi me Qenie Njerëzore”

Kosova, me një sipërfaqe prej 10.887 km² dhe popullësi rreth 2 milionë banorë⁸, ndodhet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik.

Ndryshimet e ndodhura në rajonin e Ballkanit pas viteve 1990, si pasojë e tensioneve dhe konflikteve të armatosura në ish Jugosllavi, kanë sjellë ndryshime të mëdha jo vetëm në hartën politike të rajonit, por edhe në situatën sociale ekonomike të vendeve. Kosova, me pozitën qendrore në Gadishullin Ballkanik, me burimet ekonomike e njerëzore, me lidhjet e shumta me vendet përreth, mundëson zhvillimin ekonomik e social duke ruajtur strukturën multietnike, dhe synon integrimin euroatlantik.

Kosova karakterizohet nga një popullësi e re në moshë, ku rreth 50% është nën moshën 24 vjeç dhe vetëm 8% e saj është mbi moshën 64 vjeç. Krahasuar me vendet e rajonit, Kosova ka shkallën më të lartë të papunësisë. Vlerësohet se në vitin 2008, 48% e fuqisë punëtore ishte e papunë. Papunësia ka tendencë të jetë afatgjatë, ku përafërsisht 82% e të papunësuarve janë të papunë për më shumë se 12 muaj. Shkalla e papunësisë për të rinjtë është 73%. Po ashtu, kjo shkallë e papunësisë shënohet edhe me dallimet mes gjinive. Shkalla e papunësisë për femrat është 55%, kurse për meshkujt është 39%. Numri i nxënësve që detyrohen të largohen nga shkolla vazhdon të jetë shqetësues, posaçërisht vajzat. Në periudhën 2005-2008, rritja e Bruto Prodhimit Vendor (BPV) u përshpejtua edhe njëherë me rritje mesatare vjetore prej mbi 4%, dhe arriti në 5.4 % në vitin 2008⁹.

Indikatorët makroekonomik dhe tradicional shoqëror të Kosovës nuk janë inkurajues, me rritje të kufizuar të (BPV), e cila nuk po arrin të ulë shkallën e papunësisë prej 48% dhe atë të varfërisë që vazhdon të mbetet në 4.5%.

Këta tregues të ulët social ekonomik, ilustrjnë kontradiktat zhvillimore të vendit të cilat kanë gjeneruar jo vetëm probleme ekonomike dhe sociale, por edhe probleme që lidhen me krimin e organizuar. Aktualisht, Kosova konsiderohet si burim, destinacion dhe ndoshta vend tranzit i trafikimit të qenieve njerëzore.

⁸ Rezultati Paraprak i REKOS <http://esk.rks-gov.net/rekos2011/repository/docs/REKOS%20LEAFLET%20ALB%20FINAL.pdf>⁸

⁹ Të dhënat për treguesit janë marrë nga Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2010, Tabela 2.2, faqe 38

Mungesa e të dhënave statistikore periodike të unifikuara mbi dhunën në familje, na detyron që të vazhdojmë të përdorim rezultatet nga anketat, studimet dhe hulumtimet e kryera, si bazë për formulimin e politikave dhe programeve kundër dhunës në familje, nga institucionet qendrore dhe lokale. Disa prej informatave të rëndësishme vazhdojnë të jenë relevante dhe të bazuara në perceptimet e popullatës mbi fenomenin. Megjithatë konsultimi me këto studime e hulumtime na përfron me situatën reale të dhunës në familje në Kosovë.

Në prill të vitit 2008, ABGJ ndërmorri iniciativën të hulumtojë çështjet e dhunës në familje në Kosovë, të cilin e realizoi Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës (RRGK) me mbështetjen e UNDP/WSSI Plus, hulumtim i cili rezultoi me një raport “*Siguria fillon në shtëpi*”. Gjetjet e këtij hulumtimi tregojnë se¹⁰:

- Në Kosovë dhuna në familje është një formë e dhunës me bazë gjinore, që në pjesën dominuese të rasteve kryhet nga burrat ose partnerët kundër grave dhe vajzave;
- Më shumë se një e treta e të anketuarve besojnë se “është e natyrshme të ndodh dhuna në familje kur çifti grindet”;
- Dhuna seksuale nuk njihet si dhunë familjare nëse ajo ndodh ndërmjet partnerëve;
- 50% e të anketuarve (më shumë gratë se burrat) kanë pohuar se “nganjëherë fëmija ka nevojë të rrihet me shuplaka”;
- 40% e të anketuarve kanë pohuar se të moshuarit janë barrë e familjes;
- 9.1% e të anketuarve janë pajtuar me faktin se personat me aftësi të kufizuara duhet të rrinë të mbyllur se janë turp për familjen;
- 82% e të anketuarve kanë pranuar se e konsiderojnë dhunën në familje një turp i cili nuk duhet të dalë jashtë shtëpisë;
- 40% e të anketuarve të cilët kanë përjetuar dhunë, kanë deklaruar se askujt nuk i kanë treguar për këtë rast;
- Femrat që jetojnë në zonat rurale të varfëra janë më të prirura të përjetojnë dhunë;
- Institucioni i cili është më i besueshëm për personat e dhunuar është Policia e Kosovës, e cila ka edhe rastet më të shumta të denoncimit të dhunës;

Nga kjo kuptojmë që situata socio-ekonomike në vend, varfëria, papunësia, shkalla e lartë e braktisjes së shkollimit të obliguar, vetëdija jo në nivel dhe shumë faktorë tjerë tërthorazi ndikojnë në rritjen e shkallës së dhunës në familje dhe trafikimit me qenie njerëzore. Jo të gjitha rastet e

¹⁰Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimtimit 2011-2014, fq 23-24 Hulumtimi Me çfarë çmimi
faqe 86

dhunës në familje dhe jo të gjithë keqbërësit e trafikimit me qenie njerëzore raportohen dhe kapen nga organet përgjegjëse, kjo do të thotë se në realitet numri i rasteve të tilla është shumë më i madh në realitet.

2.1. Korniza ligjore e Kosovës mbi dhunën në familje dhe trafikimin e qenieve njerëzore

Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje nr. 03/L-033 ka për qëllim parandalimin e dhunës në familje, në të gjitha format e saj, me masa të përshtatshme ligjore, të pjesëtarëve të familjes, që janë viktimat të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. Ky ligj, poashtu, ka për qëllim edhe trajtimin e kryerësve të dhunës në familje dhe lehtësimin e pasojave.

Parandalimi dhe luftimi i dhunës në familje kërkon angazhimin e strukturave të ndryshme publike dhe private për të diskutuar dhe zgjidhur çështjet e arsimimit, shëndetit, punësimit, drejtësisë, familjes, fëmijëve, të moshuarve, të shërbimeve sociale, për më tepër procesit të zhvillimit të një shoqërie. Strukturat ligjbërëse dhe ekzekutive, dhe organizatat jo-qeveritare, kanë të gjitha funksione specifike dhe programi kombëtar dhe plani për veprim i unifikojnë këto dhe ndajnë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit.

Mbështetje të theksuar në dënimin e personave që ushtrojnë këtë dhunë luan edhe Kodi Penal i Kosovës, 03/L-002 dhe Kodi i Procedurës Penale 03/L-003.

Në anën tjetër legjislacioni i cili mbështet luftimin e fenomenit të trafikimit me qenie njerëzore mbështetet në një gamë të gjërë ligjesh, dokumentesh dhe konventash ndërkombëtare dhe ligjet vendore siç janë:

- Deklarata Universale mbi të Drejtat e Njeriut.
- Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (2005) dhe raporti i saj shpjegues.
- Protokolli opcional i Konventës për të drejtat e fëmijës, trafikimin, prostitucionin dhe pornografinë e fëmijëve (2002).
- Protokolli i Kombeve të Bashkuara për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit me qenie njerëzore.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
- Kodi Penal i Kosovës, 03/L-002.
- Kodi i Procedurës Penale 03/L-003.
- Ligji i Policisë së Kosovës 03/L-035.
- Ligji i Punës No. 03/L-212 Date 02/11/2010.

- Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje 2010/03-L-182.
- Kodi i Drejtësisë për të Mitur 2010/03-L193.
- Ligji për Barazi Gjinore 2004/2.
- Ligji për Shëndetësinë 2004/4.
- Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Krimit Kibernetik 2010/03-L-166, etj.

2.2. Misioni, Vizioni dhe Qëllimi i PKKDhF-PV 2011-2014 dhe SNKTQNj-PV 2011-2014

Strategjitetë Nacionale dhe Planet e Veprimit janë dokumente dinamike të cilat ndryshohen dhe plotësohen në mënyrë të vazhdueshme dhe shërbejnë si bazë për të hartuar strategji për periudhat e ardhshme kohore, sidoqoftë misioni ynë mbetet i qartë; parandalimi i dhunës në familje dhe trafikimit me qenie njerëzore dhe vizioni ynë është “një shoqëri pa dhunë në familje” dhe “një shoqëri që jeton në paqe dhe e pa u kërcënuar nga trafikimi dhe krimi i organizuar”

	PKKDhF-PV 2011-2014 ¹¹	SNKTQNj-PV 2011-2014 ¹²
Misioni	Misioni ynë është të angazhohemi për të ndërtuar një Kosovë me një mjedis social, ekonomik dhe ligjor i cili garanton që anëtarët e familjes (gratë dhe vajzat) të jetojnë në një shoqëri pa dhunë, ku do të kenë hapësirë për t'u përfshirë në lëvizje aktive për ndryshimin e jetës së tyre. ➤ Të krijojmë mekanizma efektiv për parandalimin, mbrojtjen, trajtimin, rehabilitimin dhe integrimin e viktimave të dhunës. ➤ Të gjejmë sa më shumë rrugë për të fuqizuar dhe përfshirë në jetën normale çdo individ të përjashtuar dhe marginalizuar përshkak të dhunës në familje. ➤ Të ndërgjegjësojmë shoqërinë tonë për problemet e dhunës në familje, si një nga shkaktarët e problemeve sociale dhe ekonomike.	Misioni i kësaj strategjie, është të përcaktoj prioritetet strategjike të luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore, të përcaktoj objektivat specifike të institucioneve që marrin detyrime në luftën kundër trafikimit, si dhe të harmonizoj veprimet ndër-institucionale për arritjen e objektivave të përcaktuara. Gjithashtu, misioni i kësaj strategjie është të siguroj rritjen e cilësisë së shërbimeve, duke reduktuar dëmet e trafikimit ndaj shoqërisë si dhe të intensifikoj ndjekjen, persekutimin dhe dënimin e shkelësve të ligjit.

¹¹ Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit 2011-2014

¹² Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2011-2014

	PKKDhF-PV 2011-2014¹¹	SNKTQNj-PV 2011-2014¹²
Vizioni	<i>Një shoqëri pa dhunë në familje, ku të drejtat e secilit prej anëtareve të saj të vlerësohen dhe respektohen.</i> <i>Një shoqëri ku secili respektohet dhe është në gjendje të realizojë potencialin që ka, pa dhunë dhe diskriminim.</i> <i>Një shoqëri ku çdo qytetar mund të shprehë nevojat dhe prioritetet e veta, dhe ku Qeveria dëgjon dhe vepron në mënyrë të tillë që këto prioritete të jenë në qendër të politikave publike.</i>	<i>Vizioni i kësaj strategjie është “Koordinimi i luftës kundër trafikimit me qenie njerëzore për të ndërtuar një shoqëri që jeton në paqe dhe e pa kërcënuar nga trafikimi dhe krimi i organizuar, duke krijuar në këtë mënyrë imazhin e Kosovës, si një vend i qetë e me standarde të larta të sigurisë”.</i>
Qëllimi	<i>Duke u nisur nga tre prioritetet e përcaktuara: Parandalimi, Mbrojtja dhe Përkrahja, Programi ka për qëllim kryesor të sigurojë ndryshimin afatgjatë të sjelljes dhe kulturës së shoqërisë kosovare, ndaj këtij fenomeni. Gjithashtu ky program kërkon të konsolidojë bashkëveprimin dhe ndërveprimin ndërmjet akterëve, me qëllim që dhuna në familje të adresohet në mënyrë efektive.</i>	<i>Synimet strategjike janë formuluar për të dhënë një përgjigje adekuate ndaj çështjeve të trafikimit me qenie njerëzore, që duhen adresuar në të ardhmen, nëpërmjet metodave të reja ligjore e institucionale.</i> <i>Strategjia trajton katër fusha kryesore:</i> <i>• Parandalimi i trafikimit.</i> <i>• Mbrojtja dhe ndihma e viktimave dhe dëshmitarëve.</i> <i>• Hetimi, arrestimi dhe ndëshkimi i krimeve të trafikimit.</i> <i>• Mbrojtja e fëmijëve.</i>

2.3. Objektivat specifike të PKKDhF-PV 2011-2014¹³

2.3.1. Objektivi specifik 1

Parandalimi dhe përfshirja - Deri në vitin 2013, të krijohen mekanizma efikas dhe gjithëpërfshirës për parandalimin e dhunës në familje.

- **Objektiv specifik 1.1** - Të hartohen politika në nivel qendror dhe lokal për parandalimin, mbrojtjen dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat dhe ushtruesit e dhunës në familje.
- **Objektiv specifik 1.2** - Të sensibilizohet shoqëria mbi dhunën në familje.
- **Objektiv specifik 1.3** - Të krijohen mekanizma për edukimin dhe vetëdijësimin e të rinjve mbi dhunën në familje.
- **Objektiv specifik 1.4** - Të rritet masa e raportimit të dhunës në familje.

2.3.2. Objektivi specifik 2

Mbrojtja - Deri në vitin 2013, të janë siguruar mekanizma efikas të mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje.

- **Objektiv specifik 2.1** - Të sigurohen shërbime efikase për mbrojtjen fizike të viktimave të dhunës në familje në të gjithë territorin e Kosovës.
- **Objektiv specifik 2.2** - Të ngriten kapacitetet e akterëve (policisë, prokurorisë, gjykatave dhe qendrave për punë sociale) për trajtimin e dhunës në familje.
- **Objektiv specifik 2.3** - Të sigurohet ndihma juridike falas për viktimat e dhunës në familje.

2.3.3. Objektivi specifik 3

Shërbimet - Të sigurohen shërbime efikase për rehabilitimin dhe integrimin e viktimave dhe kryerësve të dhunës në të gjithë territorin e Kosovës si dhe të rrisim qasjen e viktimave ndaj këtyre shërbimeve.

- **Objektiv specifik 3.1** - Të ndërtohen dhe fuqizohen kapacitete të punonjësve të

¹³ Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Plani i veprimit 2011-2014

shëndetësisë, të shërbimeve sociale, dhe arsimore për ofrimin e shërbimeve viktimave të dhunës në familje.

- **Objektiv specifik 3.2** - Të ngriten politika të mbështetjes ekonomike të viktimave dhe ushtrueseve të dhunës.
- **Objektiv specifik 3.3** - Të ndërtohen dhe fuqizohen shërbime sociale (shëndetësore, arsimore, sociale, ekonomike, juridike) për viktimat dhe kryerësit e dhunës në familje.

2.4. Objektivat specifike të SNKTQNj-PV 2011-2014¹⁴

2.4.1. Parandalimi

Synim strategjik 1 - Të ngritet vetëdijësimi i publikut mbi çështjet e trafikimit me qenie njerëzore.

- **Objektivi specifik 1** - Të vetëdijësohen grupet e rrezikuara dhe ato të interesit (fëmijëve, të rinjëve, grave dhe burrave) për çështjet e trafikimit.
- **Objektivi specifik 2** – Të vetëdijësohet publiku i gjerë lidhur me sanksionet ligjore për trafikimin me qenie njerëzore.

Synim strategjik 2 – Të shtohet efikasiteti i parandalimit të trafikimit në të gjitha nivelet e arsimit.

- **Objektiv specifik 1** - Të plotësohen kurrikulat edukativo-arsimore me informacionet e duhura për parandalimin e trafikimit.
- **Objektiv specifik 2** - Të rritet përfshirja e grupeve të rrezikuara në arsimim joformal.
- **Objektiv specifik 3** - Të trajtohet me efikasitet problemi i braktisjes së shkollës nga nxënësit.

Synim strategjik 3 - Të ngriten kapacitetet e burimeve njerëzore në parandalimin e trafikimit dhe bashkëpunimi ndërinstitutional.

- **Objektiv specifik 1** - Të zhvillohen dhe avancohen kapacitetet e institucioneve shtetërore në parandalimin e trafikimit.
- **Objektiv specifik 2** - Të ngriten kapacitetet e institucioneve arsimore në parandalim të trafikimit.

¹⁴ Strategjia Nacionale Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2011-2014.

- **Objektiv specifik 3** - Të ngriten kapacitetet e OJQ-ve dhe grupeve joformale në parandalimin e trafikimit.
- **Objektiv specifik 4** - Të forcohet bashkëpunimi ndërinstitutional, si dhe me komunitetin në parandalimin e trafikimit.

2.4.2. Mbrojtja dhe ndihma e viktimave dhe dëshmitarëve

Synim strategjik 1 - Të përmirësohet identifikimi dhe referimi i viktimave të trafikimit me qenie njerëzore.

- **Objektiv specifik 1** - Avancimi i procedurave ekzistuese të identifikimit dhe referimit për viktimat e trafikimit.
- **Objektiv specifik 2** – Ngritja e kapaciteteve institucionale për identifikimin e viktimave të trafikimit.

Synim strategjik 2 – Bashkërendimi dhe bashkëveprimi i suksesshëm dhe cilësor i shërbimeve për viktimat e trafikimit.

- **Objektiv specifik 1** - Avancimi i gjithëmbarrshëm i kornizës ligjore ekzistuese.
- **Objektiv specifik 2** - Fuqizimi i mekanizmit referues, ngritja e kapaciteteve institucionale dhe ofrimi i shërbimeve të qëndrueshme për viktimat e trafikimit.
- **Objektiv specifik 3** - Sigurimi i shërbimeve të qëndrueshme dhe afatgjate për viktimat e trafikimit.

Synim strategjik 3 - Reintegrimi i qëndrueshëm i viktimave të trafikimit.

- **Objektiv specifik 1** - Avancimi i shërbimeve reintegruese afatgjate për viktimat e trafikimit.
- **Objektiv specifik 2** - Bashkërendimi dhe bashkëveprimi i shërbimeve riadhesuese për viktimat e huaja të trafikimit.
- **Objektiv specifik 3** - Bashkërendimi dhe bashkëveprimi i shërbimeve për vendosje në vendet e treta për viktimat e trafikimit të përfshira në programin e dëshmitarit të mbrojtur.

2.4.3. Hetimi dhe ndëshkimi i krimeve të trafikimit

Synim strategjik 1 - Të avancohen teknikat e hetimit me qëllim të rritjes së efikasitetit kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

- **Objektiv specifik 1** - Të ndryshohet/revidohet si dhe plotësohet korniza ligjore lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore.
- **Objektiv specifik 2** - Ngritja e kapaciteteve institucionale (policisë, prokurorisë dhe gjykatave) në drejtim të përdorimit të teknikave të hetimit.
- **Objektiv specifik 3** - Koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të policisë, prokurorisë, gjykatave, doganave, Administratës Tatimore, dhe Inspektoriatet përkatëse.

Synim strategjik 2 – Të forcohet dhe zhvillohet bashkëpunimi me shtetet tjera dhe organizatat ndërkombëtare për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore.

- **Objektiv specifik 1** - Bashkëpunimi me shtetet tjera dhe me organizatat ndërkombëtare Interpol/Europol/Eurojust/Seci/Frontex për hetimet e përbashkëta.

Synim strategjik 3 - Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit të policisë, prokurorisë dhe gjykatave për hetimin dhe ndëshkimin e kryeresve të trafikimit.

- **Objektiv specifik 1** - Ngritja e kapaciteteve të policisë, prokurorisë dhe gjykatave.
- **Objektiv specifik 2** - Përmirësimi i politikave ndëshkimore për trafikantët dhe shkelësit e ligjit.

Synim strategjik 4 - Konfiskimi i pasurisë së fituar me trafikim dhe kompensim të viktimave.

- **Objektiv specifik 1** - Arritja e zbatimit të procedurave të konfiskimit të pasurisë së trafikantëve.
- **Objektiv specifik 2** - Të zbatohen procedurat standarde për viktimat e trafikimit sipas ligjeve vendore dhe standarde ndërkombëtare.

Synim strategjik 5 - Trajtimi adekuat dhe jo diskriminues ndaj viktimave.

- **Objektiv specifik 1** - Të zbatohen procedurat standarde për viktimat e trafikimit sipas ligjeve vendore dhe standardeve ndërkombëtare.

Synim strategjik 6 - Të arrihet ngritje cilësore profesionale nëpërmjet trajnimeve.

SNKTQNj-PV 2011-2014 poashtu përfshin edhe shtyllën që trajton çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe nuk trajtohet në këtë raport.

III. Përparimi në implementimin e Programit të Kosovës dhe Planit të Veprimit Kundër Dhunës në Familje (PKKDHF-PV 2011-2014) në nivelin qendror dhe lokal

Dhuna në familje është një fenomen mjaft i përhapur në shoqërinë tonë dhe si rrjedhojë, është përgjegjësia e shtetit, komunitetit dhe individëve të ndërmarrin veprimet e nevojshme për ta ndaluar atë. Posaqërisht pas aprovimit të strategjisë kundër dhunës në familje e deri më sot është e domosdoshme që qeveria me përpikmëri të punojë në realizimin e objektivave të parapara në këtë strategji.

Bazuar në Programin e Kosovës dhe Planit të Veprimit kundër Dhunës në Familje 2011-2014 është përcaktuar plani i detajuar për realizimin e hapave konkret gjatë katër viteve.

Ky plan i veprimit është i ndarë në tri shtylla:

1. Parandalimi dhe përfshirja,
2. Mbrojtja, dhe
3. Shërbimet (Rehabilitimi dhe integrimi).

3.1. Parandalimi

Është shtylla e parë e programit, ku institucionet me një bashkëpunim të mirëfilltë do të synojnë të identifikojnë mënyra për edukimin dhe vetëdijësimin e shoqërisë Kosovare për dhunën në familje dhe pasojat e saj, si dhe të rrisë kapacitetet e komunitetit në mënyrë që t'i përgjigjen fenomenit të dhunës.

Gjithashtu, programi synon të identifikoj mënyra dhe mjete që viktimat e dhunës në familje të marrin informacionin e nevojshëm për të përmirësuar sigurinë dhe mirëqenien e tyre.

Parandalimi i dhunës në familje angazhon të gjitha institucionet dhe OJQ-të që të unifikohen dhe të ndajnë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit.

Në bazë të hulumtimit të bërë për periudhën janar – dhjetor 2011, institucionet e përfshira si aktere kryesore në zbatim të PKKDHF-PV 2011-2014, kanë realizuar disa nga objektivat e parapara me planin e veprimit për vitin 2011. Duhet të potencohet fakti se strategjia është aprovuar në gusht të vitit 2011 dhe institucionet kishin në dispozicion vetëm katër muaj për të implementuar planin programin për të njëjtin vit. Në vazhdim janë listuar disa nga institucionet e monitoruara dhe aktivitetet e ndërmara në nivelin qendror dhe lokal:

3.1.1. Agjencioni për Barazi Gjinore

ABGJ ka hartuar Programin e Kosovës Kundër Dhunës në Familje dhe Planin e Veprimit 2011-2014. Programi ngërthen në vete angazhimin e të gjithë akterëve dhe aktivistëve, që për vite me radhë kanë trajtuar problemin e dhunës në familje, në nivel institucional, qendror dhe lokal, përfaqësues të universitetit, shoqërisë civile, koalicionit të strehimoreve, etj. Programi u miratua me vendimin e Qeverisë së Kosovës, nr. 08/34 me 25.08.2011.

Aktivitetet e ndërmarra nga ABGJ janë kryesisht të lidhura me realizimin e:

Objektivave specifik 1.2: *Të sensibilizohet shoqëria mbi dhunën në familje, si dhe*

Objektivi 1.3: *Të krijohen mekanizma për edukimin dhe vetëdijesimin e të rinjve mbi dhunën në familje;*

- Më 25 Nëntor 2011 (25 Nëntori shënohet si dita ndërkombëtare për eliminimin e dhunës ndaj gruas) ABGJ ka organizuar një tryezë diskutimi ku u prezantua Programi i Kosovës Kundër Dhunës në Familje, dhe Planin e Veprimit, 2011- 2014, të miratuar nga qeveria. Me këtë rast fushata 16 ditëshe zyrtarisht u hap nga Presidentja e Kosovës, zonja Atifete Jahjaga. Ngjarja kishte përcjelljen e mediave televizive, radio dhe atyre të shkruara. ABGJ gjithashtu ka publikuar dhe shpërndarë 60 postera me mesazhin *“Paqja në Botë fillon me paqen në shtëpi”*.
- ABGJ ka realizuar një videoklip me qëllim të sensibilizimit të opinionit mbi fenomenin e dhunës në familje dhe rëndësinë e raportimit. Ky videoklip u shfaq në televizionin publik, në TV KLAN, TV KOHA.
- ABGJ në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës ka botuar dhe vendosur në rrugën magjistrale 60 postera me mesazhin *“Kundër Dhunës Ndaj Gruas”*.
- ABGJ në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik ka ndërmarrë iniciativën për të realizuar spotin televiziv ku Ministri i MZHE-së, Z. Besim Beqaj, ka folur mbi pasojat e dhunës në familje, efektin negativ dhe dëmet që kjo dukuri shkakton në shoqëri.

Në anën tjetër Zyret për Barazi Gjinore në nivelin komunal kanë organizuar disa aktivitete:

- Zyra për Barazi Gjinore në Gjiilan/Gnjilane ka publikuar broshurën në tri gjuhë, mbi rëndësinë e raportimit të dhunës në familje. Gjithashtu është vendosur një pano në qendër të qytetit të Gjiilanit/Gnjilane me tekstin: *“Kërko ndihmë, Ligji të mbron”*.

- Zyra për Barazi Gjinore në Drenas/Glogovac me qëllim të sensibilizimit të opinionit mbi fenomenin e dhunës në familje ka publikuar 60 posterë, dhe 175 fletëpalosje.
- Zyra për Barazi Gjinore në Kaçanik/Kaçanik me përkrahjen e organizatës zvicerane LLOGOS, ka organizuar fushatë senzibilizuese me anë prezantimit të katër ligjëratave për gratë e fshatrave të komunës së Kaçanikut/Kaçanik ku është prezantuar Ligji për Barazi Gjinore, Ligji mbi Trashëgiminë, dhe Ligji për Mbrojtje nga Dhuna në familje.
- Zyra për Barazi Gjinore në Lipjan/Lipljane me rastin e shënimit të 25 Nëntorit, (Ditës Ndërkombëtare kundër dhunës ndaj gruas) ka organizuar shfaqjen e filmit dokumentar “*Ligji Mbron*”. Gjithashtu është organizuar një debat publik mbi fenomenin shqetësues të dhunës në familje dhe janë shpërndarë posterë, broshura e kordele të bardha.
- Zyra për Barazi Gjinore në Gjakovë/Djakovica ka shënuar 25 Nëntorin me një debat të mbajtur në Kuvendin Komunal mbi fenomenin e dhunës në familje, përkrahjen dhe vështirësitë. Pjesëmarrës ishin përfaqësues nga gjykatat, Policia, QPS-ja dhe OJQ-të.
- Zyra për Barazi Gjinore në Prizren/Prizren ka organizuar fushatën : “*Kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje*” me nëpunëset e Kuvendit Komunal të Prizrenit/Prizren me ç’rast është realizuar një aktivitet senzibilizues ku janë shpërndarë fletëpalosje me mesazhe parandaluese. Me qëllim të ngritjes së vetëdijes mbi këtë fenomen shqetësues, janë realizuar ligjërata dhe debate me nxënës të klasave të IX-ta nga gjashtë shkolla fillore të Komunës së Prizrenit/Prizren në temën “*Dhuna në familje*”, janë shpërndarë fletëpalosje dhe postera me mesazhe edukative.

3.1.2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

- MASHT gjatë kësaj periudhe ka arritur të fut në kurrikulat mësimore (që mësohet në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar dhe në Fakultetin e Edukimit) temat nga fushat e të drejtave të njeriut nëpërmjet lëndës së edukatës qytetare duke synuar formimin e individit të aftë të jetojë në respektimin e të drejtave të njeriut, të tolerancës dhe solidaritetit njerëzor. Në këto kurikula janë përfshirë modulet: Çfarë janë stereotipet dhe rolet gjinore, si ta mbaj dhunën larg jetës sime, si të kujdesëm për shëndetin tim, çfarë është trafikimi me qenie njerëzore, çfarë është seksualiteti etj.

- MASHT po ashtu ka siguruar që gjatë hartimit të Kornizës së Kurrikulës për Arsim Parauniversitar të Republikës së Kosovës¹⁵ gjejjësisht në planprogramet e lëndëve përkatëse shkollore, të reflektohen edhe dokumentet për të drejtat e njeriut dhe parandalimi i trafikimit me qenie njerëzore.
- Një objektivë shumë e rëndësishme që është përmbushur nga MASHT është përfshirja e 80 pedagogëve dhe psikologëve nëpër shkolla në gjithë territorin e Kosovës.¹⁶ *(sidoqoftë në disa shkolla mungon psikologu për shkak të buxhetit¹⁷).*

3.1.3. Mediat

Informimi mbi dhunën në familje nga ana e mediave ka rëndësi të madhe për krijimin dhe promovimin e një opinioni të fuqishëm shoqëror kundër dhunës në familje.

Mediat duhet të kenë një rol të rëndësishëm në krijimin dhe promovimin e një opinioni të fuqishëm shoqëror kundër dhunës në familje. Ato duhet të jenë më të ndjeshme ndaj fenomenit të dhunës në familje, më këmbëngulëse në promovimin e vlerave të familjes dhe të kenë qëndrim të prerë kundër stereotipeve me bazë gjinore. Informimi mbi dhunën në familje nga ana e mediave ka rëndësi të veçantë për qasjen në mënyrë kritike ndaj fenomenit të dhunës në familje. Është shumë me rëndësi përcjellja e mesazheve në interes të vetëdijesimit të popullatës dhe sidomos brezit të ri për përvetësimin e vlerave themelore të demokracisë që mbështeten në respektimin e drejtave të njeriut, të tolerancës dhe solidaritetit njerëzor. Gjatë vitit 2011 është realizuar vetëm një reklamë e përgaditur nga ABGJ që është transmetuar disa herë në TV 21 dhe TV KLAN, ndërsa televizioni publik i Kosovës nuk ka bërë asgjë në këtë aspekt. Kur bëhet fjalë për televizionet lokale, shumica e tyre as nuk ishin në dijeni për ekzistimin e PKKDH-PV 2011-2014. Mediat tjera, ato të shkruara dhe elektronike nuk ofrojnë hapësirë të mjaftueshme për temat e ndërlidhura me dhunën në familje. Edhe përkundër faktit se janë parashtruar kërkesa në disa medime për ofrim të informacionit zyrtar lidhur me punën e tyre për senzibilizimin e opinionit publik për fenomenin e dhunës në familje, nuk janë përgjigjur pozitivisht ndaj kërkesës dhe nuk kanë ofruar ndonjë përgjigje.

Radio Kosova/Blu Sky i ka kushtuar kujdes temës në fjalë duke përfshirë disa tema në kuadër të emisionit “Bota F”, emisioni i cili i kushtohet para së gjithash “Botës Femërore”. Emisioni transmetohet çdo të shtunë nga ora 11.30 në valët e Radio Kosovës. Minutat e këtij emisioni

¹⁵ Korniza e Kurrikulës për Arsim Parauniversitar të Republikës së Kosovës, miratuar nga MASHT me 29.08.2011

¹⁶ Bazuar nga raporti i pranuar nga MASHT

¹⁷ Bazuar në hulumtimi në terren

janë të rezervuara për të trajtuar tema ku, protagonistet kryesore janë femrat, vizionet, sukseset dhe hallet e tyre. Në kuadër të këtij emisioni janë përfshirë temat në vijim¹⁸:

- Janar: Shifrat alarmante për përdhunimet në Kosovë (pas luftës),
- Shkurt: Intervistë me drejtoreshën e QMGF, Naime Sherifi me temën: Dhuna në familje,
- Mars: Vetëvrasjet në Kosovë, kush dhe pse një njeri ia merr jetën vetës,
- Prill: Raportet brenda familjes sot,
- Maj: Femrat dhe dukuritë e shëmtuara (droga, prostitucioni, krimi),
- Qershor: Dhuna ndaj gruas,
- Nëntor: Femra dhe krimi,
- Dhjetor: Fushata kundër dhunës ndaj gruas.

Në studio është ftuar psikologja Luljeta Prekazi - psikologe, njëherësh koordinatore e Qendrës për mbrojtjen e viktimave të dhunës dhe trafikimit.

3.2. Mbrojtja dhe siguria

Është shtylla e dytë e PKKDH-PV 2011-2014. Ajo përmban aktivitete të cilat do të ndikojnë në sigurimin dhe mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, nëpërmjet shërbimeve adekuate ligjore dhe sociale, siç janë mbrojtja ligjore dhe ajo fizike.

3.2.1. Prokuroria e shtetit - Zyra për mbrojtje dhe ndihmë viktimave

Rolin kryesor për rastet e dhunës në familje e kanë Mbrojtësit e Viktimave. Detyrë kyçe e mbrojtësit të viktimave është mbrojtja dhe përfaqësimi i të drejtave të viktimave të krimit, me theks të veçantë viktimave të dhunës familjare, keqtrajtimit seksual, trafikimit me qenie njerëzore, abuzimet e fëmijëve dhe krimeve të tjera.

Bazuar nga raportin e pranuar nga Prokuroria e Shtetit - Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave për vitin 2011, mbrojtësit e viktimave ishin të kompletuar me trajnime dhe ishin në gadishmëri 24 orë gjatë gjithë ditëve të javës që të ofrojnë ndihmë të viktimave dhe në mbrojtjen e të drejtave të tyre si përfaqësues të autorizuar.

Gjatë kësaj kohe, mbrojtësit e viktimave kanë ndihmuar dhe përfaqësuar rastet ku janë përfshirë viktimat e krimit nga të gjitha regjionet e Kosovës.

¹⁸ Bazuar në raportin nga Radio Kosova

Mbrojtësit e viktimave ofrojnë këto shërbime: informim, këshilla ligjore, përpilimi i shkresave për urdhër mbrojtje, padi të ndryshme, shërbime mjekësore, shërbime për akomodim dhe strehim, shërbime të rehabilitimit, shoqërim dhe përfaqësim në polici, prokurori e gjykata.

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave nuk posedon një databazë të ndarë të rasteve për vitin kalendarik 2011. Të dhënat e pranuar nga kjo zyrë ofrojnë informacion për periudhën nëntë mujore **01.06.2011 - 31.03.2012**, dhe sipas këtyre të dhënave numri i rasteve të asistuar nga mbrojtësi i viktimave gjatë kësaj periudhe është **742** raste. Përshkrimi i detajuar i rasteve është paraqitur në tabelën në vijim.

Përshkrimi	Numri i rasteve
Raste të natyrës dhunim apo tentim dhunim	13
Raste të natyrës dhunë në familje	599
Raste të natyrës abuzim seksual	23
Urdhëra për mbrojtje të inicuar nga mbrojtësit e viktimave	98
Urdhëra të lëshuar për mbrojtje emergjente	12
Viktima të dhunës në familje të strehuara	58
Viktima të trafikimit me qenie njerëzore	18
Viktima të dhunuara	1
Viktima të përfaqësuar në seanca gjyqësore	473
Viktima të përfaqësuar në prokurori	80
Këshilla juridike të ofruara nga MV	144
Informim ligjor i ofruar nga MV për lëndët dhe procedurat gjyqësore dhe të prokurorisë	281
Viktima të shoqëruara në Qendrat për Punë Sociale	47
Raste të paraqitura si krim i përsëritur	28
Viktima të shoqëruara në PK për të dhënë deklaratë	9
Padi të përpiluara	204
Viktima të shoqëruara për mjekim	11

Tablela 1. Numri i rasteve të asistuar nga mbrojtësi i viktimave gjatë periudhës 01.06.2011-31.03.2012

Në kuadër të zyrës së mbrojtësve të viktimave ka filluar të funksionoj edhe **linja SOS** e cila është pajisur me aparaturë dhe me inventar pune, donacion ky i OSBE-së.

Zyra e Njesisë së Operatoreve të linjës SOS u ofron ndihmë viktimave potenciale të të gjitha llojeve të krimit si të dhunës, viktimave të trafikimit dhe qytetarëve dhe mundëson thirrje pa pagesë për marrje të këshillave dhe për të raportuar rastin e tyre në institucionet përkatëse. Gjatë periudhës së njëjtë kohore janë regjistruar: 34 thirrje informuese, 6 thirrje këshilluese dhe 17 thirrje referuese.

Mangësi në këtë fushë mbetet numri i vogël i stafit të personave që punojnë si mbrojtës të viktimave në disa regjione si: Peja/Peć dhe Prizreni/Prizren. Problemet kryesore që janë vërejtur gjatë këtij monitorimi përfshijnë vonesat për të caktuar seanca gjyqësore ose për të vendosur mbi kërkesat për urdhër për mbrojtje apo urdhër për mbrojtje emergjente, dështimi për t'i përfshirë përfaqësuesit e qendrave për punë sociale në procedurat civile për dhunën në familje, zbatimi i gabueshëm i ligjeve përkatëse nga ana e gjykatave dhe dështimi për t'i ndjekur veprat penale.

Prokuroria mund të zbusë dhe zhdukë këto probleme vetëm me zbatimin e plotë dhe të drejtë të Ligjit për mbrojtjen nga Dhuna në Familje.

3.2.2. Policia e Kosovës

Policia e Kosovës është përgjegjëse që t'i përgjigjet secilit njoftim për vepër apo kërcënim të kryerjes së akteve të dhunës në familje, ose shkeljes së një urdhëri për mbrojtje, urdhëri për mbrojtje emergjente ose një urdhëri për mbrojtje të përkohshme emergjente, pa marrë parasysh se kush e bën njoftimin. Përveç shqiptimit të urdhërave për mbrojtje të përkohshme emergjente, Policia e Kosovës është përgjegjëse për përdorimin e mjeteve të arsyeshme për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje dhe për të parandaluar dhunën e mëtutjeshme, duke:

- krijuar një linjë të posaçme telefonike për raportim të dhunës në familje;
- siguruar kontaktin zyrtar me nëpunësin hetues të policisë për viktimën apo përfaqësuesin ligjor të viktimës;
- informuar viktimën, përfaqësuesin ligjor ose mbrojtësin e viktimës për të drejtat e viktimës në përputhje me Ligjin për mbrojtje nga Dhuna në Familje, duke përfshirë të drejtën për të kërkuar urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente;
- informuar viktimën lidhur me shërbimet e ndihmës ligjore, psikologjike dhe ndihmës tjetër në dispozicion nga institucionet qeveritare si dhe prej rrjetit të autorizuar të OJQ-ve;
- informuar ofruesit gjegjës të shërbimeve lidhur me ndonjë rast të dhunës në familje dhe mundësimin e kontaktit me viktimën me kërkesë të viktimës;

- siguruar mbrojtjen për personin i cili ka lajmëruar incidentin, nëse paraqitet nevoja dhe në përputhje me obligimet gjegjëse ligjore për mbrojtjen e dëshmitarëve;
- siguruar transportin për viktimën dhe nëse është e nevojshme edhe të varësve të saj deri në:
 - objektin e duhur mjekësor për trajtim dhe kontroll mjekësor;
 - vendstrehim apo vendqëndrim tjetër të sigurt dhe të përshtatshëm, me kërkesën e viktimës;

Policia e Kosovës ka botuar broshura për vetëdijësimin e viktimave të dhunës dhe për të drejtat e tyre.

Gjatë vitit 2011 në Policinë e Kosovës në tërë territorin e Kosovës janë paraqitur **1046 raste** të dhunës në familje. Nga ky numër i paraqitur **804 raste** kanë qenë femra ndërsa **242** meshkuj.

Në vazhdim janë paraqitur në mënyrë tabelare rastet e dhunës në familje për vitin 2011 sipas të dhënave zyrtare të pranuar nga Policia e Kosovës.

Rajonet Policore / Muajt	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Rajoni i Prishtinës/Priština	17	20	23	21	18	21	20	32	19	30	25	22	268
Rajoni i Gjilanit/Gnjilane	6	6	6	5	10	11	11	10	9	9	11	15	109
Rajoni i Ferizajit/Uroševac	15	5	5	2	4	4	19	14	9	14	9	8	108
Rajoni i Pejës/Peć	11	18	19	20	20	16	23	15	20	16	16	13	207
Rajoni i Prizrenit/Prizren	15	9	12	12	22	23	17	14	16	11	5	16	172
Rajoni i Mitrovicës/Mitrovica	28	15	16	16	13	17	20	9	15	9	16	8	182
Nr. Total	92	73	81	76	87	92	110	94	88	89	82	82	1046

Tabela 2: Numri i rasteve të dhunës në familje për vitin 2011 sipas të dhënave zyrtare të PK.

Veprat Penale /Rajonet Policore	Prishtina- Priština	Gjilani- Gnjilane	Ferizaji- Uroševac	Peja-Peć	Prizreni	Mitrovica- Mitrovica	Totali
Vrasje	1	1	0	1	1	0	4
Vrasje në tentativë	2	0	1	0	0	0	3
Shtytja në vetëvrasje	3	0	0	0	3	0	6
Ndihma në vetëvrasje	0	0	0	0	0	0	0
Lëndimi i lehtë trupor	132	76	101	54	100	106	569
Lëndimi i rëndë trupor	5	2	0	0	7	0	14
Shtrëngimi	0	0	0	0	1	0	1
Kanosje	84	14	2	1	41	54	196
Privimi i kundërligjshëm nga liria	0	0	0	0	0	0	0
Dhunim	2	0	0	0	0	3	5
Sulmi seksual	2	0		3	0	0	5
Degradimi i integritetit seksual	0	0		0	0	0	0
Keqpërdorimi seksual i personave me çrregullime mendore emocionale ose me paaftësi mendore	0	0	0	0	0	0	0
Keqpërdorimi seksual i personave nën moshën gjashtëmbëdhjetë vjet	0	0	0	0	0	0	0
Marrëdhëniet seksuale brenda në Familje	0	0	0	1	0	0	1
Shkelja e Detyrimeve Familjar	1	0	0	0	1	0	2
Përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes	0	2	1	1	0	0	4
Çdo veprim tjetër i një anëtarit të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike	1	0	0	0	0	0	1
Shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit;	0	0	0	0	1	0	1
Sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat;	23	5	0	80	1	1	110

Veprat Penale /Rajonet Policore	Prishtina / Pristina	Gjilani / Gnjilane	Ferizaji / Urosevac	Peja / Pec	Prizreni / Prizren	Mitrovicë / Mitrovica	Totali
Ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë;	3	6	0	57	5	2	73
Përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qellim te përluljes se personit tjetër;	1	0	0	0	0	10	11
Marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual;	0	0	0	0	0	0	0
Kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër;	0	0	0	0	0	0	0
Dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë;	1	2	3	0	1	3	10
Vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike	2	0	0	0	0	0	2
Hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër;	4	0	0	1	2	0	7
Rrëmbimi	0	1	0	0	0	0	1
Shkelja e udhërit mbrojtës	1	0	0	8	8	3	20
TOTAL	268	109	108	207	172	182	1046

Tabela 3: Numri i rasteve të dhunës në familje për vitin 2011 sipas veprës penale

Sipas të dhënave të pranuar nga PK, numri më i madh i rasteve të dhunës në familje i takon kategorisë “Lëndim i lehtë trupor” me gjithësej 569 raste, pastaj është kategoria “kanosje” 196 raste dhe “sulm fizik pa marrë parasysh pasojat” janë regjistruar 110 raste.

Gjinia / Rajoni	Prishtinë- Priština	Gjilani- Gnjilane	Ferizaj- Uroševac	Peja-Peć	Prizreni Prizren	Mitrovicë Mitrovica	Totali
Femra	205	75	79	176	134	135	804
Meshkuj	46	32	29	36	46	53	242
TOTAL	251	107	108	212	180	188	1046

Tabela 4: Viktimat sipas gjinisë

Sipas të dhënave të pranuar nga PK, numri më i madh i viktimave të gjinisë femrore është raportuar në rajonin e Prishtinës/Priština, kurse numri më i madh i viktimave të gjinisë mashkullore është raportuar në rajonin e Mitrovicës/Mitrovica.

Etniciteti / Rajonet	Prishtina- Priština	Gjilani- Gnjilane	Ferizaj- Uroševac	Peja-Peć	Prizreni	Mitrovica	Nr. Totali
Shqiptar	210	87	90	170	159	132	848
Serb	27	18	5	20	0	45	115
Boshnjak	1	1	4	0	3	4	13
Turq	1	0	0	0	2	0	3
Malazez	0	0	0	0	0	0	0
Goran	1	0	0	9	7	0	17
Rom	4	0	0	5	9	6	24
Ashkali	5	0	9	7	0	1	22
Egjiptian	3	1	0	0	0	0	4
Kroat	0	0	0	0	0	0	0
Të tjerë	0	0	0	0	0	0	0
TOTAL	252	107	108	211	180	188	1046

Tabela 5: Viktimat Sipas Etnicitetit

Sipas të dhënave të pranuar nga PK, numri më i madh i viktimave i takon nacionalitetit shqiptar, gjithësejt 848 raste dhe nacionalitetit serb me 115 raste.

Procedura / Rajoni	Prishtinë- Pristina	Gjilani- Gnjilane	Ferizaj- Uroševac	Peja-Peć	Prizreni - Prizren	Mitrovicë - Mitrovica	Totali
Arrestime	55	27	10	131	42	69	334
QPS-se	222	27	62	42	64	17	434
Mbrojtës të viktimave	201	30	79	204	100	143	757
Urdhëresa mbrojtëse-Gjykatë	12	2	1	151	8	29	203
Urdhëresa mbrojtëse-Polici	0	0	0	2	0	2	4
Viktima të strehuara	12	21	3	21	10	32	99

Tabela 6: Statistika e Aplikimit të disa procedurave

Lëndet e dërguara/ Rajoni	Prishtinë- Pristina	Gjilani- Gnjilane	Ferizaj- Uroševac	Peja-Peć	Prizreni - Prizren	Mitrovicë - Mitrovica	Totali
Prokuroria Komunale	261	99	97	202	139	107	905
Prokuroria e Qarkut	4	3	2	4	6	2	21
Të mbyllura të pabaza	0	0	8	1	8	36	53
Nën hetime	1	4	1	0	19	24	49
TOTAL	266	106	108	207	172	169	1028

Tabela 7: Statusi i rasteve të dhunës familjare

Sipas të dhënave të pranuar nga PK, numri më i madh i rasteve, **905** sish janë dërguar për procedurë gjyqësore në Prokurori Komunale dhe **21** raste në Prokurori të Qarkut. Prokuroria Komunale e Prishtinës/Pristina prin me **261** raste, pastaj Peja/Peć me **202** dhe Prizreni/Prizren me **139** raste të procedura në Gjykata Komunale.

Marrëdhënia familjare / Rajoni	Prishtina- Priština	Gjilan-G njilane	Ferizaj- Uroševac	Peja-Peć	Prizreni	Mitrovica	Totali
Bashkëshortë	148	52	52	147	81	108	588
Ish-bashkëshortë	10	4	0	0	4	2	20
Bashkëjetesë	6	1	3	2	0	0	12
Babë-Djalë	36	12	14	23	24	23	132
Babë-Vajzë	14	1	6	4	7	5	37
Nënë-Djalë	18	8	10	10	9	5	60
Nënë-Vajzë	3	1	1	0	1	3	9
Vëllezër	7	4	21	7	12	19	70
Motër-Vëlla	13	6	2	3	3	7	34
Motra	2	1	0	0	0	1	4
Vjehrra-Reja	2	3	2	4	6	2	19
Vjehri-Reja	2	1	2	1	2	1	9
Kunatat	0	1	7	0	0	0	8
Kunata-kunati	1	3	6	3	4	2	19
Vjehrra-Dhëndri	0	2	0	0	0	0	2
Halla-nipi	0	1	0	1	0	0	2
Axha- djali i vëllait	1	0	0	0	1	2	4
Gjyshi-nipi	0	2	0	0	0	1	3
Gjyshja-nipi	0	0	0	0	0	2	2
Gjyshi/ja-mbesa	2	0	0	0	0	0	2
Njerka-Thjershtër	0	1	0	0	1	0	2
Djali i axhës / vajza e axhës	3	0	4	0	0	3	10
Të tjera:	0	0	0	2	17	1	20
TOTAL	268	104	130	207	172	187	1068

Tabela 8: Marrëdhënia familjare në mes të viktimës dhe të dyshuarit

Sipas të dhënave të pranuar nga PK, numri më i madh i rasteve të raportuara si dhunë në familje i takon kategorisë dhunë në mes të bashkëshortëve me **588** raste, pasuar me raste të dhunës në mes të djalit dhe babës me **132** raste.

3.3. Përkrahja, trajtimi dhe reintegrimi

Është shtylla e tretë e PKKDHf-PV 2011-2014, në kuadër të së cilit do të identifikohen dhe ofrohen forma veprimi me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për përkrahjen e viktimave të dhunës në familje, trajtimin profesional të kryerësve dhe abuzuesve të dhunës në familje deri në integrimin e plotë të tyre në jetën normale. Reintegrimi i viktimave të dhunës në familje është një proces i gjatë që kërkon një qasje multi-disciplinare dhe njëkohësisht një kyçje të të gjithë akterëve që punojnë në mbrojtjen dhe ofrimin shërbimeve për viktimat e dhunës deri në një fuqizim të plotë të viktimës.

Në këtë aspekt, MPMS dhe MSH kishin për obligim që të hartojnë udhëzimin administrativ për përcaktimin e vendit dhe mënyrës për trajtimin psikosocial të viktimave të dhunës në familje. Gjithashtu obligim i MPMS-së është edhe mbështetja e strehimoreve.

3.3.1. Ministria e Shëndetësisë

Sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, MSH-ja është e obliguar që të nxjerrë akte nënligjore, për mënyrën e trajtimit të personave ndaj të cilëve është shqiptuar masa mbrojtëse e trajtimit të obligueshëm mjekësor, atyre nga varësia e alkoolit dhe substancave psikotrope.

Gjithashtu është e nevojshme që viktimat e dhunës në familje të jenë kategori e veçantë dhe të lirohen nga pagesa e shërbimeve shëndetësore.

Bazuar në raportin e pranuar nga Minsitria e Shëndetësisë, në kuadër të Njesisë së të Drejtave të Njeriut në MSH u realizuan vizita në shtatë (7) Drejtori të Shëndetësisë Komunale si në: Prishtinë/Priština, Prizren/Prizren, Pejë/Peć, Gjakovë/Djakovica, Mitrovicë/Mitrovica, Gračanica/Graçanicë dhe Gjiilan/Gnjilane.

Në këto vizita ndër të tjera u diskutua çështja e trafikimit dhe referimi i viktimave të trafikimit nga ana e stafit mjekësor si dhe ofrimi i shërbimeve shëndetësore viktimave të trafikimit nga ana e stafit mjekësor. Nga të gjitha vizitat e realizuara rezulton se institucionet shëndetësore të kujdesit primar janë të gatshme për të ju ofruar shërbime shëndetësore viktimave të trafikimit dhe janë në bashkëpunim me policinë e Kosovës, qendrat për punë sociale dhe strehimoret. Si pengesë u potencua se viktimat e trafikimit nuk janë të liruara nga pagesa e shërbimeve shëndetësore me ligj, mirëpo çdo herë kanë marrë shërbime shëndetësore pa pagesë.

Duke iu referuar të njëjtit raport, nga objektivat e PKKDFH-PV 2011-2014 është parë si e domosdoshme që viktimat e trafikimit të lirohen nga pagesa e shërbimeve shëndetësore, me këtë rast është përgatitur propozimi edhe i është drejtuar Grupit Parlamentar për draftimin e ligjit për shëndetësi. Propozimi është përkrahur ku me këtë rast viktimat e trafikimit do të futen në ligj si kategori e veçantë që duhet të lirohen nga pagesa.

MSH ka realizuar hulumtimin “Identifikimi dhe Referimi i viktimave të Trafikimit të Qenieve Njerëzore nga Stafi Mjekësor”, ku në muajin mars 2011 janë përgatitur pyetësorët e dedikuar stafit mjekësor të cilët më pas janë shpërndarë në institucione shëndetësore në tri nivele të kujdesit shëndetësor, në atë: parësor, dytësor dhe tretësor. Gjatë shpërndarjes së pyetësorëve janë realizuar edhe vizita në spitale, ku është diskutuar rreth çështjeve të trafikimit dhe mënyrës së si i marrin shërbimet shëndetësore viktimat e trafikimit në spitale regjionale. Në muajin maj 2011 janë mbledhur pyetësorët dhe është realizuar raporti i hulumtimit, me të cilin janë identifikuar nevojat dhe njohuritë e stafit mjekësor rreth identifikimit dhe referimit të viktimave të trafikimit nga stafi mjekësor.

3.3.2. Strehimoret

Një rol shumë të rëndësishëm në mbrojtjen nga dhuna në familje luajnë edhe strehimoret. Strehimorja është një vend i sigurt ku viktimat e dhunës në familje dhe fëmijët e tyre mund të qëndrojnë përkohësisht dhe ato ofrojnë mbrojtje dhe shërbime tjera. Aktualisht, ekzistojnë strehimore në Gjakovë/Djakovica, Gjiell/Gnjilane, Mitrovicë/Mitrovica, Pejë/Peć, Prishtinë/Priština dhe Prizren/Prizren, si dhe strehimoret e veçanta, si ajo për viktimat me rrezikshmëri të lartë: Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Strehimorja për Fëmijë (*Hope and Homes*) që strehojnë viktimat të komuniteteve nga e tërë Kosova. Viktimat mund të qëndrojnë gjashtë muaj në strehimore. Kjo periudhë mund të vazhdohet në marrëveshje me MPMS-në. Strehimoret zakonisht iu sigurojnë viktimave strehim, ushqim, veshëmbathje, këshilla (psiko-sociale dhe ligjore), mbështetje mjekësore, aftësim profesional, edukim shëndetësor, shërbime për kërkim të punës dhe veprimtari për fëmijët. Strehimoret patrollohen nga policia dhe kanë aranzhime të ndryshme të sigurisë.

Gjatë vitit 2011 Koalicioni i Strehimoreve të Kosovës (KSK) realizoi disa takime në kuadër të bashkëpunimit të strehimoreve me akteret tjerë siç janë: Koordinatorin Nacional Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore (KNKT), PK, MD, MPMS, MSH, OJQ-të, etj. Në këto takime u diskutuan çështje të ndryshme, si çështje më e rëndësishme u potencua mos licencimi i strehimoreve si

dhe mbështetja joadekuate e strehimoreve me mjete financiare nga ana e institucioneve shtetërore.

Bazuar nga të dhënat e pranuar nga KSK dhe strehimoret në pesë regjionet e Kosovës, të dhënat janë këto:

Asociacioni: Shpresa dhe Shtëpitë e Fëmijëve-Kosovë – Prishtinë/Priština

Tipi/Viti	2011 (Janar- Tetor)
Femra (>18 vjet)	0
Adoleshent (12-18 vjet)	16
Fëmijë (<12 vjet)	9
Totali	25

Tabela 9: Numri i viktimave

Gjinia/Viti	2011 (Januar-Tetor)
Femra	13
Meshkuj	12
Totali	25

Tabela 10: Gjinia e viktimave

Nacionaliteti	Numri
Shqiptar i Kosovës	Pa të dhëna
Serb i Kosovës	Pa të dhëna
Shqiptarë (nga shtetet fqinje)	Pa të dhëna
Serbë (nga shtet fqinje)	Pa të dhëna
RAE	Pa të dhëna
Minoritet tjera Kosovare (Turq, Kroat, Boshnjak, etj.)	Pa të dhëna
Te tjerët nga Europa Lindore	Pa të dhëna
Nacionalitet tjera	Pa të dhëna
Totali	Pa të dhëna

Tabela 11: Nacionaliteti

Asociacioni: Qendra për Mbrojtjen dhe Rehabilitimin e Grave dhe Fëmijëve “Liria” - Gjilan/Gnjilane.

Tipi/Viti	2011 (Janar-Tetor)
Femra (>18 vjet)	56
Adoleshent (12-18 vjet)	28
Fëmijë (<12 vjet)	54
Totali	138

Tabela 12: Numri i viktimave

Gjinia/Viti	2011 (Janar-Tetor)
Femra	115
Meshkuj	23
Totali	138

Tabela 13: Gjinia e viktimave

Nacionaliteti	Numri
Shqiptar i Kosovës	139
Serb i Kosovës	5
Shqiptarë (nga shtetet fqinje)	6
Serbë (nga shtet fqinje)	3
RAE	3
Minoritet tjera Kosovare (Turq, Kroat, Boshnjak, etj.)	7
Te tjerët nga Europa Lindore	4
Nacionalitet tjera	1
Totali	168

Tabela 14: Nacionaliteti i viktimës i strehuar për periudhën 1Janar 2009 – 31 Tetor 2011

Asociacioni: Shtëpia e sigurtë – Gjakovë/Djakovica

Tipi/Viti	2011
Femra (>18 vjet)	26
Adoleshent (12-18 vjet)	7
Fëmijë (<12 vjet)	37
Totali	70

Tabela 14: Numri i viktimave

Gjinia/Viti	2011
Femra	52
Meshkuj	18
Totali	70

Tabela 15: Gjinia e viktimave

Nacionaliteti	Numri
Shqiptar i Kosovës	157
Serb i Kosovës	0
Shqiptarë (nga shtetet fqinje)	13
Serbë (nga shtet fqinje)	3
RAE	27
Minoritet tjera Kosovare (Turq, Kroat, Boshnjak, etj.)	0
Te tjerët nga Europa Lindore	4
Nacionalitet tjera	0
Totali	204

Tabela 16: Nacionaliteti i viktimës i strehuar për periudhën 1Janar 2009 – 31 Tetor 2011

Qendra për Mirëqenjen e Gruas – Pejë/Peć

Tipi/Viti	2011 (Janar- Tetor)
Femra (>18 vjet)	34
Adoleshent (12-18 vjet)	11
Fëmijë (<12 vjet)	22
Totali	67

Tabela 17: Numri i viktimave

Gjinia/Viti	2011 (Janar-Tetor)
Femra	54
Meshkuj	13
Totali	67

Tabela 18: Gjinia e viktimave

Nacionaliteti	Numri
Shqiptar i Kosovës	226
Serb i Kosovës	0
Shqiptarë (nga shtetet fqinje)	7
Serbë (nga shtet fqinje)	2
RAE	18
Minoritet tjera Kosovare (Turq, Kroat, Boshnjak, etj.)	5
Te tjerët nga Europa Lindore	3
Nacionalitet tjera	3
Totali	264

Tabela 19: Nacionaliteti i viktimës i strehuar për periudhën 1Janar 2009 – 31 Tetor 2011

Asociacioni: Qendra për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve – Prizren/Prizren (QSGF-P)

Tipi/Viti	2011 (Janar- Tetor)
Femra (>18 vjet)	12
Adoleshent (12-18 vjet)	3
Fëmijë (<12 vjet)	11
Totali	26

Tabela 20: Numri i viktimave

Gjinia/Viti	2011 (Janar-Tetor)
Femra	21
Meshkuj	5
Totali	26

Tabela 21: Gjinia e viktimave

Nacionaliteti	Numri
Shqiptar i Kosovës	88
Serb i Kosovës	0
Shqiptarë (nga shtetet fqinje)	10
Serbë (nga shtet fqinje)	2
RAE	4
Minoritet tjera Kosovare (Turq, Kroat, Boshnjak, etj.)	3
Te tjerët nga Europa Lindore	0
Nacionalitet tjera	0
Totali	107

Tabela 22: Nacionaliteti i viktimës i strehuar për periudhën 1 Janar 2009 – 31 Tetor 2011

3.3.3. Qendra për Punë Sociale

QPS-të luajnë një rol kyç në mbështetjen e viktimave të dhunës në familje në gjykata dhe polici, posaçërisht kur viktimat janë të mitur ose pa zotësinë e veprimit. Përveç kësaj, QPS-ja vlerëson gjendjen e viktimave të dhunës në familje dhe ndihmon për të gjetur zgjidhjen më të mirë për viktimën. QPS mund po ashtu të kryejë vizita në shtëpi dhe mund të ndërlidhet me spitalet dhe shtëpitë e sigurta. QPS-të mund të ofrojë këshilla psiko-sociale dhe ligjore për viktimat. QPS gjithashtu mund të përfshijë një viktimë në skemën e ndihmës sociale (nëse viktima gëzon këtë të drejtë).

Bazuar në të dhënat e grumbulluara nga hulumtimi në teren, janë mbledhur këto të dhëna:

- Në QPS në Prizren/Prizren gjatë vitit 2011 kanë qenë 47 raste të dhunës në familje.
- Në QPS në Malishevë/Mališevo në vitin 2011 janë trajtuar 4 raste të dhunës në familje dhe 1 rast i trafikimit.
- Në QPS në Dragash/Dragaš vitin 2011 janë trajtuar 8 raste të dhunës në familje, kurse viktima të trafikimit nuk është evidentuar asnjë rast.
- Në QPS në Suharekë/Suva Reka gjatë vitit 2011 janë trajtuar 8 raste të dhunës në familje dhe 1 rast i trafikimit.
- QPS-të në regjionin e Prizrenit/Prizren nuk kanë realizuar asnjë aktivitet për sensibilizimin e popullatës mbi dhunën në familje apo trafikimin e qenieve njerëzore.
- Në QPS në Kamenicë/Kamenica janë trajtuar gjithsej 5 raste të dhunës në familje. Prej tyre tri viktima të moshës madhore dhe dy të mitur. Viktimat e moshës madhore që të tria janë femra.
- Në QPS në Novo Bërdë/Novo Bordo janë trajtuar gjithsej 5 raste, nga të cilat 4 raste kanë qenë të komunitetit shqiptar ndërsa 1 rast ka qenë i komunitetit serb. Rastet e paraqitura kryesisht kanë qenë të gjinisë femërore. Tri raste kanë qenë të strehuara në shtëpinë e sigurtë në Gjilan/Gnjilane për 15 ditë, mirëpo pas kësaj kohe janë kthyer në familjet e tyre.
- Në QPS në Gjilan/Gnjilane janë trajtuar gjithsej 4 raste të dhunës, 3 femra dhe një mashkull, të gjithë janë të komunitetit shqiptar, ndërsa fëmijë dhe rast të trafikimit me qenie njerëzore nuk janë evidentuar.
- Në QPS në Viti/Vitina janë trajtuar gjithsej 16 raste të dhunës në familje, 14 femra dhe 2 meshkuj. Nacionaliteti i viktimave të dhunës në familje është: 15 shqiptar, 1 serb.
- Në QPS në Ferizaj/Uroševac janë trajtuar gjithsej 8 raste të dhunës në familje, viktimat e dhunës kanë qenë gra, 6 raste kanë qenë shqiptare, ndërsa 2 raste kanë qenë të komunitetit ashkali.

- Në QPS në Kaçanik/Kaçanik janë raportuar gjithësej 9 raste të dhunës në familje, 2 fëmijë dhe 7 gra, ndërsa fëmijë dhe raste të trafikimit me qenie njerëzore nuk janë evidentuar.
- Në disa qytete të Kosovës në kuadër të QPS mungon psikologu (Klina/Klina, Peja/Peć, Istog/Istok, Skënderaj/Srbica, Gjakova/Djakovica, Podujeva/Podujevo) dhe kjo është një problem i madh për ofrim të shërbimit adekuat për viktimat. Në shumicën e komunave ku mungon psikologu, problemi qëndron te mungesa e mjeteve financiare.
- Gjithashtu edhe përfaqësues të QPS-ve nuk kanë njohuri për hartimin e programeve për punonjësit social. I gjithë stafi trajnohet në vazhdimësi për të trajtuar viktimat e dhunës në familje.

3.3.4. Gjyqësori

Këshilli Gjyqësor i Kosovës nuk posedon të dhëna të sakta për periudhën kohore janar – dhjetor 2011, të ndara bazuar në alinetë 4 dhe 3 të nenit 153, gjegjësisht 154 të Kodit të Procedurës Penale të cilat identifikojnë veprën penale të shkaktuar si pasojë e dhunës në familje. Rastet e dhunës në familje janë klasifikuar së bashku me të gjitha rastet tjera në kuadër të një kategorie “*lëndim i lehtë trupor*” apo “*lëndim i rëndë trupor*”.

Bazuar në Buletinin e Jurisprudencës për persona të mitur për periudhën janar – dhjetor 2011, të botuar në korrik të vitit 2012 nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës, në Gjykatat e Kosovës janë paraqitur këto raste:

- Lëndimi i lehtë trupor 79 raste, 76 meshkuj dhe 3 femra (neni 153 KPK)
- Lëndimi i rëndë trupor 25 raste, 25 meshkuj dhe asnjë femër (neni 154 KPK)

Bazuar në Buletinin e Jurisprudencës për persona të rritur për periudhën janar – dhjetor 2011, të botuar në qershor të vitit 2012 nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës në Gjykatat Komunale në Kosovë janë paraqitur këto raste:

- Lëndimi i lehtë trupor 2208 raste, 2147 meshkuj dhe 61 femra
- Lëndimi i rëndë trupor 136 raste, 133 meshkuj dhe 3 femra

Bazuar në Buletinin e Jurisprudencës për persona të rritur për periudhën janar – dhjetor 2011, të botuar në qershor të vitit 2012 nga Agjensioni i Statistikave të Kosovës, në Gjykatat e Qarkut në Kosovë janë shqiptuar dënime për këto raste:

- Lëndimi i lehtë trupor 38 raste, që të gjithë personat e gjinisë mashkullore
- Lëndimi i rëndë trupor 15 raste, që të gjithë personat e gjinisë mashkullore.

Bazuar në të dhënat e mbledhura nga disa gjykata komunale dhe të qarkut në Kosovë, të dhënat për rastet e dhunës në familje të paraqitura në disa gjykata janë këto:

Gjykata Komunale / Qarkut	Numri i rasteve të reja	Numri i rasteve të zgjidhura
Gjykata Komunale në Prizren/Prizren	16	4
Gjykata Komunale në Mitrovicë/Mitrovica	83	76
Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica	12	12
Gjykata Komunale në Prishtinë/Priština	60	58
Gjykata Komunale në Klinë/Klina	22	20
Gjykata Komunale në Deçan/Dečane	13	pa të dhëna
Gjykata Komunale në Istog/Istok	30	pa të dhëna
Gjykata Komunale në Gjakovë/Djakovica	28	pa të dhëna
Gjykatat tjera	pa të dhëna	pa të dhëna

Tabela 23: Të dhënat për rastet e dhunës në familje të regjistruara në Gjykatat Komunale dhe të Qarkut

Të dhënat nga gjykatat tjara komunale dhe ato të qarkut mungojnë pasi që asnjë nga gjykatat në Kosovë nuk posedon një databazë të të dhënave të përpiluara për vitin paraprak të gatshëm për t'ia ofruar palëve të interesit, në këtë rast OJQ-ve. Gjithmonë duke iu referuar të dhënave nga zyrtarët për marrëdhënie me publikun të gjykatave, referentëve apo gjyqëtarëve të kontaktuar, përpunimi i të dhënave është proces i vështirë dhe i gjatë, pasi që kërkon të shikohen të gjitha librat në mënyrë manuale dhe të nxirret numri i saktë i rasteve të dhunës në familje. Në gjykatat tjera, ne kemi parashtruar kërkesë me shkrim por ende deri më sot nuk kemi mar përgjegje nga asnjëra gjykatë. Pasi që koha ishte e limituar për mbledhje të informacionit dhe hartim të këtij raporti, periodha pritëse zyrtare prej 14 ditësh ishte pengesë për të grumbulluar më tepër informacion nga gjykatat. Në anën tjetër KGJK nuk posedon databazë të rasteve të dhunës në familje për vitin 2011 dhe nga hulumtimi ynë kemi kuptuar që askush nga KGJK nuk është i informuar për rrjedhat e implementimit të SNKTQNJ-PV 2011-2014 dhe PKKDHF-PV 2011-2014 dhe obligimet që dalin nga këto strategji për KGJK-në.

IV. Përparimi në implementimin e Strategjisë Nacionale dhe Planit të Veprimit kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore 2011-2014 në nivelin qendror dhe lokal

Trafikimi me qeniet njerëzore paraqet një nga format më agresive të krimit të organizuar, i cili tenton të dëmtojë dinjitetin e shoqërisë kosovare.¹⁹ Lufta kundër trafikimit me qenie njerëzore nuk përfshinë vetëm dënimin e personave të cilët merren me trafikim por edhe parandalimin e trafikimit dhe mbrojtjen e viktimave.

SNKTQNJ-PV 2011-2014 është hartuar për t'iu përgjigjur problemeve të trafikimit me qenie njerëzore në Kosovë. Akterët kryesor për hartim dhe zbatim të kësaj strategjie janë: Ministria e Punëve të Brendshme, Koordinatori Nacional kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, Sekretariati, Grupi Ndërmënyor, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe Njësitë për të Drejtat e Njeriut.

Koordinatori Nacional kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore do të jetë personi i cili koordinon dhe organizon punën për hartimin dhe zbatimin e kësaj strategjie²⁰.

Në anën tjetër **Sekretariati** kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore do të mbështesë koordinatorin në të gjitha aktivitetet dhe do të monitorojë e raportojë për zbatim të kësaj strategjie.

Ndërkaq **Grupi ndërmënyor** është një grup i përfaqësuesve të institucioneve qendrore, mandati i të cilit është të koordinojë zbatimin e politikave, të monitorojë dhe raportojë mbi të arriturat.

¹⁹ SNKTQNJ-PV 2011-2014, fq. i

²⁰ SNKTQNJ-PV 2011-2014, fq. 3




Figura 1: Struktura organizative dhe Mekanizmat koordinues, monitorues dhe implementues kundër Trafikimit me Qeniet Njërzore në Kosovë²¹

²¹ SNKTQNJ PV 2011-2014

4.1. Plani i veprimit

Bazuar në SNKTQNJ-PV 2011-2014 është përcaktuar plani i detajuar për realizimin e hapave konkret gjatë katër viteve.

Strategjia trajton katër shtylla kryesore:

1. Parandalimi i trafikimit;
2. Mbrojtja dhe ndihma e viktimave dhe dëshmitarëve;
3. Hetimi, arrestimi dhe ndëshkimi i krimeve të trafikimit; dhe
4. Mbrojtja e fëmijëve.

4.1.1. Parandalimi i trafikimit

Aktivitetet parandaluese duhet të adresojnë shkaqet kryesore që çojnë një person në rrjetin e trafikimit: varfëria, problemet sociale, moskomunikimi, mungesa e informacionit lidhur me këtë fenomen, mungesa e informacionit për lëvizjen e lirë, arsimimi apo punësimi.

Lidhur me këtë fushë, në bazë të informacionit të pranuar nga institucionet relevante, ato kanë realizuar aktivitetet e cekura në vazhdim:

4.1.2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë

Në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore nëpër shkolla fillore të Kosovës gjatë vitit 2011, kanë filluar të krijohen ekipe për parandalimin dhe reagimin kundër braktisjes së shkollës nga ana e nxënësve, faktor ky shumë i rëndësishëm i cili tërthorazi ndikon edhe në parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore.

MASHT ka bashkëpunuar me Organizatën AED (Akademia për Zhvillimin e Arsimit) e cila ka ofruar mundësinë e mbështetjes të 15 shkollave për realizimin e projekteve të tyre në sferën e parandalimit të trafikimit. Atyre shkollave u janë dhënë grante të vogla për të zhvilluar aktivitete brenda shkollave me qëllim të ngritjes së vetëdijes së nxënësve rreth kësaj dukurie negative të realitetit tonë.

MASHT-i vazhdon zbatimin e lëndës mësimore “Aftësitë për jetën” e cila ndër të tjera trajton temën e trafikimit me njerëz, e cila mësohet në klasën e VIII dhe përveç tjerash përfshinë modulet: *çfarë janë stereotipet dhe rolet gjinore, si ta mbaj dhunën larg jetës sime, si të kujdesëm për shëndetin tim, çfarë është trafikimi me qenie njerëzore, çfarë është seksualiteti etj.*

Lënda “Aftësitë për jetën”, ka për qëllim që nxënësit t’i pajisë me njohuri, sjellje dhe aftësi që ju nevojiten për të qenë më të përgjegjshëm në një shoqëri të qytetëruar që janë: aftësitë e të menduarit kritik, për të njohur vetveten, për të komunikuar me të tjerët, për të marrë vendime të duhura, për të gjetur gjuhën e mirëkuptimit, për të kontrolluar emocionet, streset dhe konfliktet, si dhe të promovojë sjellje të sigurta për ta parandaluar trafikimin me qenie njerëzore.

Është shumë e rëndësishme që Drejtoritë Komunale të Arsimit të fillojnë me ngritjen e akuzave ndaj prindërve të cilët nuk i regjistrojnë fëmijët në shkollë apo e ndërprejnë shkollimin e tyre të obliguar, sepse deri më sot asnjë akuzë nuk është bërë kundër këtyre prindërve që neglizhojnë fëmijët e tyre dhe e cënojnë të drejtën për shkollim.

Ekziston baza ligjore e cila e rregullon mirë çështjen e obligimeve të prindit për ta shkolluar fëmijën e tij/saj dhe kjo është e precizuar me Ligjin për Arsimin Fillor dhe të Mesëm nr. 2002/2, neni 7 “Arsimi i detyruar”.

Sipas të dhënave nga Drejtoritë Komunale të Arsimit në rajonin e Pejës/Peć gjatë vitit 2011 nuk është shënuar ndonjë fushatë apo aktivitet i ngjajshëm për parandalimin e dukurisë së trafikimit me qenie njerëzore nga ana e institucioneve.

4.2. Mbrojtja dhe ndihma e viktimave dhe dëshmitarëve

Mbrojtja dhe ndihma e viktimave dhe dëshmitarëve të trafikimit është shtylla e dytë e SNKTQNJ - PV 2011-2014. Në kuadër të kësaj shtylle ekzistojnë tri synime strategjike të cilat për qëllim kanë identifikimin e viktimave të trafikimit me qenie njerëzore, të ofrohen shërbime më të mira dhe të sigurohet reintegrimi i qëndrueshëm për këto viktimë.

Në zbatimin e këtyre objektivave rolin kryesor e bartë MPMS, Policia, Mbrojtësi i viktimave, Strehimoret si dhe MSH.

4.2.1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS)

MPMS gjegjësisht Departamenti i Mirëqenies Sociale është kompetent për mbrojtjen e të gjitha kategorive në nevojë për shërbime sociale dhe familjare ku në kuadër të këtyre kategorive hynë edhe viktimat e trafikimit, fëmijë dhe të rritur, vendor dhe të huaj.

Qendra për Punë Sociale në trajtimin e rasteve të viktimave të trafikimit është e obliguar të trajtojë rastet duke ju përmbajtur menaxhimit të rastit konform legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës por gjithherë në koordinim me subjektet tjera relevante qeveritare dhe joqeveritare që janë të mandatuara në kuadër të mbrojtjes së viktimave të trafikimit.

MPMS është anëtare e grupit ndërmintor kundër trafikimit të qenieve njerëzore, dhe gjithashtu hartuese dhe implementuese e shumë aktiviteteve në kuadër të planit nacional për luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë sa i përket fushës së mbrojtjes.

MPMS gjegjësisht Departamenti i Mirëqenies Sociale në bazë të procedurave të prokurimit gjatë vitit 2011 ka bërë vazhdimin e kontratës dhe marrëveshjes për bashkëpunim për mbështetje njëvjeçare Korrik 2011- Korrik 2012 me Organizatën joqeveritare “Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalim të Trafikimit me Qenie Njerëzore (MVPT)” ku nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale kjo OJQ është mbështetur në shumë monedha prej 18.900 euro (1,575 euro në muaj), ku me këto mjete janë paguar shërbimet që janë ofruar për viktimat e trafikimit në strehimore dhe qendrën rehabilituese në kuadër të kësaj organizate.

Në kuadër të ri-strukturimit institucional Ministria e Drejtësisë gjatë muajit Shtator 2011 ka dërguar në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale një draft memorandum të mirëkuptimit mbi bartjen e kompetencave të Strehimores së përkohshme të sigurt PVPT, strehimore kjo në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë që ka mandat strehimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit me nivel të lartë të rrezikshmërisë dhe viktimave të dhunës në familje.

Nga 1 janari 2012 kompetencat për strehimoren dhe përgjegjësitë për personelin dhe pagat e tyre janë bartur nga MD tek MPMS me nënshkrim të memorandumit të mirëkuptimit për bartjen e kompetencave në mes të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale me datë 28 Tetor 2011.

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve profesionale të subjekteve që punojnë në fushën e luftimit të trafikimit me qenie njerëzore nën patronatin e Ministrisë së Punëve të Brendshme gjegjësisht zyrës së Koordinatorit Nacional dhe me mbështetje të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë OSBE gjatë këtij viti janë organizuar trajnime mbi implementimin e dokumentit mbi procedurat standarde të veprimit për viktimat e trafikimit në Kosovë të hartuar nga MPB e Kosovës.

Pjesëmarrës në këto trajnime ishin: Nëpunësit e shërbimeve sociale nga qendrat për punë sociale, mbrojtësit e viktimave nga Ministria e Drejtësisë, hetues nga Drejtorati për hetim të trafikimit me qenie njerëzore-Ministria e Punëve të Brendshme, mjekët nga qendrat e mjekësisë familjare, zyrtarë nga doganat e Kosovës, sektori joqeveritar etj.

Qeveria e Republikës së Kosovës muajin tetor e ka shpallur muajin kundër trafikimit të qenieve njerëzore në Kosovë.

Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale-MPMS në bashkëpunim me ministritë tjera të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe me partnerët jo qeveritar kryeson Komitetin e Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punës së Fëmijëve.

Në kuadër të mbrojtjes së viktimave të trafikimit (kjo komponentë përfshinë rehabilitimin dhe re-integrimin afatgjatë) Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale MPMS dhe Organizata Gjermane për Zhvillim Ndërkombëtar "GIZ" ka nënshkruar marrëveshje të bashkëpunimit mbi implementimin e programit "Programi rajonal kundër trafikimit me qenie njerëzore dhe mbrojtja shoqërore", gjithashtu ky program shtrihet në katër shtete si: Kosovë, Maqedoni, Bosnje dhe Serbi.

Qendrat për Punë Sociale në nivel lokal janë të mandatuara të ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për të gjithë personat që kanë nevojë për shërbime sociale .

Gjatë periudhës kohore Janar - Dhjetor 2011 Qendrat për Punë Sociale kanë menaxhuar, trajtuar dhe iu është ofruar shërbim social 18 viktimave të trafikimit:

Kategoria e viktimave	Numri i viktimave
Viktima të mitura	12
Viktima të moshës madhore	5
Viktima shtetase të huaja - ndërkombëtare	1
TOTAL	18

Tabela 24: Numri i viktimave të trafikimit të asistuar nga QPS-të gjatë vitit 2011

Siç dihet personeli nga QPS-ja duhet të jetë prezent dhe t'i ofroj ndihmë çdo viktime të mitur. Numri lartpërmendur (18) paraqet vetëm numrin e viktimave të trafikimit të asistuar nga QPS-të gjatë vitit 2011 por jo edhe numrin total të viktimave, pasi që QPS-ja nuk është prezente çdoherë kur bëhet fjalë për viktimat e moshës madhore.

4.2.2. Strehimorja

Strehimorja për mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore me seli në Prishtinë/Priština (MVPT) është strehimore e cila ekskluzivisht merret me viktimat e trafikimit dhe ofron këto shërbime²²:

- Ndhmë direkte,
- Parandalimi /Ngritja e vetëdijes,
- Rehabilitimi dhe reintegrimi afatëgjatë.

Në kuptimin praktik kjo nënkupton ofrimin e: ndihmës sociale viktimave të trafikimit, parandalimi dhe edukimi, mbrojtjen dhe shkëmbimin e informatave, ngritjen e vetëdijes dhe fuqizimin e tyre, mbajtjen e trajnimeve profesionale dhe të aktiviteteve tjera rekreative, si dhe rehabilitimin dhe riintegrimin afatgjatë të viktimave të trafikimit, viktimave potenciale të trafikimit dhe fëmijëve të involvuar në punë të rënda. Duhet të potencohet që edhe strehimoret tjera trajtojnë dhe strehojnë viktimat të trafikimit.

Në bazë të të dhënave të pranuara nga KSK kjo qendër ka strehuar gjithësej 11 viktimat të trafikimit gjatë vitit 2011.

Lloji / Viti	2011 (Janar- Tetor)
Femra (>18 vjet)	6
Adoleshent (12-18 vjet)	3
Fëmijë (<12 vjet)	2
Totali	11

Tabela 25: Numri i viktimave

Gjinia/Viti	2011 (Janar-Tetor)
Femra	11
Meshkuj	0
Totali	11

Tabela 26: Gjinia e viktimave

²² <http://www.pvptcenter.net/sq/cfarebejmene.htm>

Nacionaliteti	Numri
Shqiptar i Kosovës	37
Serb i Kosovës	0
Shqiptarë	8
Serbë	2
RAE	4
Minoritet tjera Kosovare (Turk, Kroat, Boshnjak, etj.)	0
Te tjerët nga Europa Lindore	0
Nacionalitetet tjera	0
Totali	51

Tabela 27: Nacionaliteti i viktimave nga 1 Janar 2009 deri 31 Tetor 2011

4.2.3. Ministria e Shëndetësisë

MSH në bashkëpunim me OSBE-në ka organizuar trajnimin për fenomenin negativ të trafikimit me qenie njerëzore, ku janë përfshirë punëtorët social, mbrojtësit e viktimave, policët, inspektorët e punës, tregut dhe sanitar nga 5 regjionet e Kosovës.

Gjatë vitit 2011 MSH kishte një bashkëpunim të ngushtë me Policinë e Kosovës, konkretisht me Divizionin Anti-Trafikim, ku me kërkesë të tyre kanë asistuar në ofrimin e shërbimeve shëndetësore viktimave të trafikimit në raste nevojë.

MSH realizoi me sukses trajnimin për stafin mjekësor në fushën kundër trafikimit me qenie njerëzore. Në nëntor të vitit 2011 u realizua trajnimi “Referimi i Viktimave të Trafikimit nga ana e stafit mjekësor”. Trajnimin e ndoqën 35 punëtorë shëndetësor, duke përfshirë spitalet regjionale dhe qendrat e shëndetit mendor. Trajnimi u financua nga Ministria e Shëndetësisë. Si rekomandim i këtij trajnimi doli së stafi mjekësor ka shumë nevojë për mbajtjen e trajnimeve në fushën kundër trafikim pasi që në shumicën e rasteve viktimat kanë nevojë për shërbime mjekësore të ndryshme.

4.3. Hetimi, arrestimi dhe ndëshkimi i krimeve të trafikimit

Shtylla e tretë e strategjisë është e parafundit në listë por për nga rëndësia mbetet e para pasi që ndëshkimi i keqbërësve është mënyrë për të parandaluar përsëritjen e këtij fenomeni nga i njëjti person. Roli i rëndësishëm në këtë shtyllë i takon Policisë, Prokurorisë dhe Gjykatave.

4.3.1. Policia e Kosovës

Gjatë vitit 2011 Policia e Kosovës ka identifikuar 39 raste të trafikimit me qenie njerëzore, nga të cilat 35 kanë qenë të nacionalitetit kosovar ndërsa 4 kanë qenë të huaj. Nga 39 femra 17 kanë qenë të mitura. PK ka arrestuar 183 persona të cilët kanë qenë të përfshirë në trafikimin me qenie njerëzore.

Viktimat e identifikuara-origjina	2011
Kosovare	35
Moldave	0
Shiqiptare	1
Bullgare	0
Serbe	3
Polake	0
Tjera	0
Totali	39

Tabela 28: Origjina e viktimave të identifikuara gjatë vitit 2011

Arrestime të personave	2011
Kosovar	160
Shqipëtar	3
Bullgar	0
Moldav	0
Ukrainas	4
Maqedonas	1
Boshnjak	0
Serb	14
Turk	1
Totali i arrestimeve	183

Tabela 29: Numri i personave të arrestuar sipas nacionalitetit

Arrestime sipas gjinisë	2011
Meshkuj	131
Femra	52
Totali i arrestimeve	183

Tabela 30: Numri i personave të arrestuar sipas gjinisë

Viktimat e identifikuar sipas grup-moshave 2010-2011								
Gr.mosha	14--17	18--22	23—25	26--30	31--35	36--40	41-50	Totali
Viti 2011	17	13	7	1	1	0	0	39

Tabela 31: Numri i viktimave të identifikuar sipas moshës

Është brengosëse numri i lartë i viktimave të moshës së mitur, gjegjësisht 17 viktima gjatë vitit 2011.

Arrestimet sipas Veprave Penale	2011
Trafikim me Njerëz (neni 139 KPK)	91
Mundësim Prostitucioni (neni 201 KPK)	39
Marrja me Prostitucion (neni 7 KPK)	50
Fshehje e dokumentave të viktimave të trafikimit (neni	0
Vendosje e Skllavërisë, punë e detyruar (neni 137 KPK)	0
Vepra tjera penale	3
Totali i arrestimeve	183

Tabela nr. 32: Numri i personave të arrestuar sipas veprës penale të kryer gjatë vitit 2011

Gjithashtu duhet të përmendet edhe fakti se gjatë vitit të kaluar janë bastisur dhe mbyllur më shumë se 800 lokale të dyshuara si hapësira, ku ushtrohet prostitucioni dhe trafikimi.

Është shqetësuese fakti që ekziston një numër kaq i madh i lokaleve ku është ushtruar trafikimi dhe prostitucioni, por në të njëjtën kohë dhe njëkohësisht ngushëlluese fakti që janë hetuar dhe identifikuar këto vende të krimit ku ushtrohet prostitucioni.

4.3.2. Prokuroria e Shtetit

Hetimet e mirëfillta nga policia dhe përmirësimet në kujdesin ndaj viktimave nuk e përmbysin një rast të një viktime të trafikuar nëse trafikantet nuk ndiqen penalisht dhe nëse ata nuk dënohen

për veprat e tyre kriminale. Nga prokuroria pritët të rritet numri i *ndjekjeve penale të suksesshme*, si dhe të shprehen masa të duhura dënimi për të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore, nëpërmjet strukturave efikase dhe profesionale të zbatimit të ligjit.

Në vitin e kaluar në prokuroritë e Kosovës, janë ngritur akte akuzuese kundër **109 personave** të përfshirë në vepra penale që lidhen me trafikim me qenie njerëzore.

4.3.3. Gjyqësori

Për shkak të afatit të shkurt kohor për grumbullim të të dhënave dhe mos ekzistimit të një databaze të mirëfillt për numrin e rasteve të trafikimit të ngritura në gjykatë, ishte e pamundur të sigurohen të dhëna nga gjykatat.

4.4. Mbrojtja e fëmijëve

Fëmijët, gjegjësisht personat e mitur janë të rrezikuar të bëhen viktimë e trafikimit dhe disa nga faktorët kryesorë të cilët: ndikojnë në këtë konstatim janë: varfëria, niveli i ulët i shkollimit, braktisja e shkollimit të obliguar, pamundësia për qasje në informacion, problemet familjare, fëmijët e mbetur pa përkujdesje të prindërve, etj.

Trafikimi i fëmijëve në Kosovë bëhet për tri qëllime kryesore, shfrytëzim seksual, puna e detyruar dhe lypësia. *E para* prek dy grup-moshat (zakonisht vajzat) midis 15 dhe 18 vjeç, shfrytëzimi i fëmijëve për punë fillon zakonisht në moshën 13 vjeç dhe i prek njësoj djemtë dhe vajzat, kurse fenomeni i tretë prekë moshat prej foshnjeve (kur ato ekspozohen për qëllim të përfitimit financiar nëpër rrugë) e deri në moshën 18 vjeç që të dy gjinitë.

Trafikimi i fëmijëve do të thotë rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, strehimi, apo pritja e një fëmije për qëllime shfrytëzimi brenda ose jashtë vendit.²³

Shfrytëzimi i fëmijëve përfshin shfrytëzimin për qëllime prostitucioni ose ndonjë formë tjetër të shfrytëzimit seksual, shërbimet e detyruara të punës, kërkim lëmoshe të detyruar, robëri, apo praktika të ngjashme të robërisë, skllavërisë, shfrytëzimi për aktivitete kriminale, heqjen e organeve, adoptimin e paligjshëm, martesën e hershme të detyruar dhe shfrytëzimin për punët e shtëpisë. Pëlqimi i fëmijës për qëllimet e shfrytëzimit është i parëndësishëm edhe nëse nuk janë përdorur asnjë nga masat në vijim: dhuna, detyrimi, rrëmbimi, mashtrimi, keqpërdorimi i pushtetit

²³ SNKTQNJ 2011-2014 fq.16

apo veprimet e kryera deri sa është në gjendje të dobësisë (cenueshmërisë) apo nën kontrollin e personit.²⁴

Trafikimi i fëmijëve ka të bëjë jo vetëm me policinë, por edhe me sistemin e drejtësisë, sistemin arsimor dhe vetë familjen si institucion.

Trafikimi i fëmijëve është një çështje shumë e vështirë dhe shumë komplekse, për të trajtuar nuk nevojitet vetëm legjislacioni por edhe mjedisi; shumë nga fëmijët e trafikuar vijnë nga familje jo-funksionale, ka shumë raste kur lënë shkollën, hiqen nga institucionet, ndodh gjithashtu që nuk pranohen në familje etj.

Për parandalimin e trafikimit të fëmijëve përveç familjes, shumë e rëndësishme është edhe roli i shkollës, DKA-së, QPS-së dhe policisë. Fillimisht shkollat duhet të raportojnë braktisjen e shkollimit në DKA e cila më pastaj duhet të lajmëroj rastin në QPS dhe Polici dhe në rast nevojë të ngrisin aktakuza për prindër të fëmijëve që nuk dërgojnë fëmijët në shkollë fillore, sepse në terren është vërejtur një numër që nuk e ndjekin shkollën fillore e cila është e obliguar me ligj.

Drejtoria Komunale e Arsimit - Njësia për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me prindër dhe arsimtarë të Ferizajit/Uroševac ka organizuar një sërë punëtorishë mbi të drejtat e fëmijëve dhe të drejtat e njeriut, që për qëllim kanë pasur ngritjen e vetëdijes së fëmijëve mbi të drejtat e tyre. Këto punëtori janë realizuar në komunat: Gjilan/Gnjilane, Viti/Vitina, Klokot/Klokot, Han të Elezit/Elez Han, Kaçanik/Kaçanik dhe Ferizaj/Uroševac. Përveç komunës së Hanit të Elezit/Elez Han ku kanë marrë pjesë 36 nxënës, nga të gjitha komunat tjera kanë marrë pjesë nga 72 nxënës. Përveç të drejtave të njeriut/fëmijëve, në punëtori është trajtuar edhe çështja e dhunës në familje dhe raportimin e simptomave të ushtrimit të dhunës, si p.sh. ardhja e nxënësve në shkollë me shenja të dhunës në fytyrë apo trup.

Rëndësia e këtyre punëtorive me nxënës ka qenë se nxënësit e kanë shtuar informacionin e tyre për të drejtat e fëmijëve/njeriut dhe barazi gjinore, por dhe për tema të tjera relevante që bien ndesh me të drejtat e tyre. Ndonëse këto tema janë pjesë integrale të sistemit arsimor, ka ende nevojë që edhe më tej të trajtohen nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, duke e vënë në pah rolin e institucioneve arsimore në rritjen e vetëdijes për respektimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve/njeriut në vendin tonë. Gjatë këtyre punëtorive, 360 nxënës janë informuar gjerësisht mbi të drejtat e fëmijëve/ njeriut, pjesë e të cilave janë edhe çështjet gjinore dhe aspekte tjera si: trajtimi i dhunës, trafikimit me njerëz, rreziqet nga droga/narkozat. Falë një programi të organizuar nga GIZ në Prizren/Prizren është aritur që të kthehen 65 fëmijë në shkollë që e kanë braktisur mësimin e obliguar, kurse për rajone tjera nuk kemi informacion.

²⁴ Po aty

V.Përfundimi

Programi i Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Plani i Veprimit 2011-2014 është miratuar në Gusht të vitit 2011, dhe përmban objektiva të qarta të cilat është dashur të fillojnë të realizohen që nga viti 2011.

Strategjia Nacionale kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Plani i Veprimit 2011-2014 poashtu ka hyrë në fuqi në muajin Gusht të vitit 2011 dhe konsiderohet se ka objektiva të qëlluara në luftimin e kësaj dukurie negative.

Qëllimi i këtij monitorimi ishte të shihet se sa janë zbatuar në praktikë objektivat nga të dy programet nëpër komunat e Kosovës dhe ato nga niveli qendror.

Duke marrë për bazë situatën në terren nga të gjeturat gjatë monitorimit nëpër komunat e Kosovës gjatë muajit tetor 2012, del se zbatueshmëria e strategjive në fjalë është në nivelin minimal. Përparimin e vobektë të të dy strategjive mund ta kenë shkaktuar katër faktorë kryesorë:

- Aprovimi i strategjive në tremujorin e tretë të vitit 2011 dhe afati i shkurt kohor (3 muaj) për të implementuar objektivat e planeve vepruese,
- Caktimi me vonesë i koordinatorëve të strategjisë dhe programit nacional kundër dhunës në familje,
- Aktivizimi i vonshëm dhe koordinimi i dobët i të gjithë akterëve relevant në kryerjen e detyrave me të cilat i ngarkojnë këto dy dokumente, e sidomos PKKDHNF 2011-2014. Promovimi tejet i dobët i këtyre dokumenteve në nivelin qendror e posaqërisht atë lokal.

Fillimisht kërkohet një vetëdijësim i popullatës për fenomenet “dhunë në familje” dhe “trafikim me qenie njerëzore”, pastaj nevojitet senzibilizimi jo vetëm i popullatës për ekzistimin e infrastrukturës ligjore, por edhe i vet zyrtarëve të institucioneve të ndryshme në nivelin lokal për ekzistimin e dokumenteve në fjalë, gjë që nuk është bërë deri më tani apo është bërë shumë pak nga niveli qendror. Fakti brengosës është që sot ne ndodhemi në përfundim të vitit të dytë të zbatimit të këtyre dokumenteve, gjegjësisht gjysmës së afatit kohor për realizimin e strategjive dhe nuk është bërë ndonjë përparim i madh në këtë drejtim, sidoqoftë nuk mund të japim ndonjë vlerësim edhe për vitin 2012 pasi që nuk është realizuar monitorimi i implementimit të strategjive gjatë këtij viti për shkak të kohës së shkurt në dispozicion për të monitoruar të dy vitet

njëkohësisht dhe gjithashtu për shkak se viti 2012 ende nuk ishte përmbyllur në kohën kur është realizuar monitorimi për vitin 2011. Në rast se tani e tutje, institucionet do të marrin me seriozitet dhe përgjegjësi detyrat e tyre të precizuara me dokumente, atëherë mund të supozojmë se deri në përfundim të afatit kohor - viti 2014, do të kemi një situatë më të mirë qoftë në parandalimin e dhunës në familje apo dhe të parandalimit të trafikimit me qenie njerëzore, ashtu edhe në trajtimin e viktimave të këtyre veprave penale.

Që të dy dokumentet paraqesin një bazë të mirë për të organizuar akterët kryesor në parandalimin e dhunës në familje dhe trafikimit me qenie njerëzore. Sidoqoftë sfidë e madhe mbetet koordinimi i mirë në mes të të gjithë akterëve dhe realizimi me kohë i të gjitha objektivave të parapara. Ndryshimet në strukturën e institucioneve përgjegjëse, ndryshimet e koordinatorëve nacional, ndryshimet në kabinetet ministrore dhe ndryshimet në ekzekutivin e vendin ndikojnë drejtëpërsëdrejti në ngecjen e implementimit të objektivave të këtyre programeve. Mediat dhe shoqëria civile duhet të luajnë rolin e monitoruesit dhe të ngrisin në rend dite dhe të paraqesin sukseset dhe dështimet e organeve gjegjëse në zbatimin e Programit të Kosovës kundër Dhunës në Familje dhe Planit të Veprimit 2011-2014 si dhe Strategjisë Nacionale kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Planit të Veprimit 2011-2014.

VI. Rekomandime

- Të informohen institucionet lokale relevante për ekzistimin e të dy strategjive, në mënyrë që të fillohet me zbatimin e objektivave të tyre në praktikë, në ato segmente ku rrethanat ekzistuese në Kosovë mundësojnë një gjë të tillë. Nga hulumtimi ynë shihet qartë se shumica e departamenteve në nivelin komunal nuk janë në dijeni të ekzistimit të këtyre dokumenteve, prandaj promovimi i tyre është tejet i rëndësishëm për të parë rezultate konkrete në monitorimin e radhës.
- **MD/GJYQËSORI** - Ligji kundër Dhunës në Familje në Kosovë, në përgjithësi vlerësohet i mirë, mirëpo ka vërejtje në zbatimin e tij. Sidoqoftë disa akte nënligjore do të plotësonin mangësitë të cilat do të identifikoheshin nga grupi i ekspertëve. Dihet se asnjë ligj nuk është i përkryer dhe duhet të plotësohet me kalimin e kohës.
- **MD** - Ligji kundër Dhunës në Familje në Kosovë të plotësohet me akte nënligjore, si psh: neni 4, al. 3 për trajtimin psikosocial të viktimave, të definohen qartë kushtet dhe nevojat për lëshim të urdhërit për mbrojtje emergjente sipas nenit 17 të këtij ligji.
- **GJYQËSORI** – Ligji kundër Dhunës në Familje në Kosovë të zbatohet në përpikmëri neni 16, al. 1 për lëshim të urdhërit të mbrojtjes emergjente brenda afatit të paraparë me ligj, respektivisht 24 orë.
- **GJYQËSORI** - Ligji kundër Dhunës në Familje në Kosovë: të zbatohet në përpikmëri neni 27 i ligjit për të personave ndaj të cilëve është ushtruar dhuna në familje me sigurim të asistencës sociale dhe shërbime mjekësore pa pagesë.
- **MD** - Ligji kundër Dhunës në Familje në Kosovë: të plotësohet neni 25 për shkelje të urdhërit mbrojtës, duke e rritur gjobën minimale prej 200 Euro për së paku 100%.
- **GJYQËSORI** - Zbatimi i këtij ligji ngec sidomos të masat e përkohshme të cilat shqiptohen nga gjyqësori dhe poashtu dënimet janë shumë të lehta për kryerësit e veprave të përsëritura.
- **GJYQËSORI** - Ndonëse ligji parasheh dënime në të holla ose maksimum 6 muaj heqje lirie, jo rrallë ndaj kryesit të veprës penale, shqiptohet dënimi me vetëm 2 muaj burg dhe një vit dënim me kusht, që nënkupton se ai/ajo vazhdon të jetë i lirë për një vit, duke i lënë hapsirë për përsëritje të dhunës.

- **GJYQËSORI** - Rekomandohet zbatimi me përpikmëri të këtij ligji në këtë segment me qëllim të parandalimit të krijimit të recidivistëve.
- **MPMS** - Poashtu ka stagnim në zbatueshmërinë në praktikë të masës së trajtimit psikosocial pasi që ende nuk janë caktuar lokacionet ku duhet të trajtohet viktimat e dhunës në familje. Prandaj kërkohet që sa më parë të përcaktohet lokacioni në fjalë dhe viktimat të kenë mundësi t'i nënshtrohen kësaj mase që konsiderohet shumë me rëndësi për viktimat e dhunës.
- **MPMS** – Të organizoj trajnime për zyrtarët e komunave për trajtim të viktimave të dhunës. Fillimisht duhet të bëhet analiza e nevojës për trajnime e pastaj të caktohen trajnimet e jo të shkohet me përsëritje të trajnimeve të njëjta disa herë në të njëjtat qendra sociale. Fillimisht MPMS duhet të njoftoj më tepër të gjitha QPS-të lidhur me strategjitë në fjalë.
- **QEVERIA E KOSOVËS** – Të siguroj financim të plotë dhe stabil për të gjitha strehimoret aktive në Kosovë, duke ofruar ndihmë financiare, inventar dhe sigurim të objekteve më të mira dhe më të sigurta për disa strehimore.
- **QEVERIA E KOSOVËS** – Të siguroj financim 100% për strehimoret aktive në Prishtinë/Priştina, Pejë/Peć, Mitrovicë/Mitrovica, Gjiilan/Gnjilane dhe Prizren/Prizren, pasi që ato aktualisht ndodhen në një gjendje shumë të vështirë financiare, pa mbështetje të mirëfilltë nga donatorët. Mbështetja financiare nga donatorët nuk siguron stabilitet dhe siguri afatgjatë për këto institucione. Një pjesë e mjeteve për financim të këtyre institucioneve mund të sigurohet edhe nga konfiskimi i aseteve të paligjshme të trafikantëve të përfituara nga aktivitetet kriminale, pastaj përmes asistimit ofruar strehimoreve për realizim të pilot projekteve të ndryshme fitim-prurëse, ngritja e një fondi të veçantë për strehimoret, ofrimi i ndihmës financiare për strehimoret për sigurimin e hapësirave të veçanta për punë (prodhim, punë dore) të cilat më vonë do të siguronin të ardhura shtesë për strehimoret, aplikimi i tarifave të veçanta për çmimet e energjisë elektrike, ujë, telefon, ngrohje, lirim nga pagesa e tatimit në të ardhura (donacione), etj.
- **MSH/MPMS** – Të sigurojnë dhe financojnë pagesën për psikologë për të gjitha strehimoret.
- **MASHT** – Të organizoj fushata për vetëdijesimin e nxënësve për rrezikun e trafikimit me qenie njerëzore.

- **MSH** – Të organizoj trajnime për personelin shëndetësorë për trajtimin e viktimave të dhunës në familje dhe të trafikimit.
- **MSH** – Të krijoj një databazë elektronike në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare për të evidentuar rastet e dhunës në familje.
- **ABGJ**- Të punoj në sensibilizimin e shoqërisë për çështjet që kanë të bëjnë me problematikën e dhunës në familje.
- **MPB (PK)**- Të trajnoj stafin e Njësitit kundër Dhunës për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje si dhe kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore.
- **PK** - Të krijohen hapësira për vendosjen e fëmijëve në stacionet policore derisa nëna e tyre intervistohet në lidhje me dhunën që është ushtruar ndaj saj.
- **KGJK** – Të vazhdoj të punoj për specializimin e gjyqtarëve në fushën e trafikimit me qenie njerëzore, si dhe të rris numrin e gjyqtarëve nëpër gjykata.
- **KGJK** – Të caktoj një person që do të përcjell zbatimin e të dy programeve dhe të raportoj suksesin e arritur në zbatim të objektivave.
- **PROKURORIA E SHETIT** – Të vazhdoj të punoj në specializimin e prokurorëve për ndjekjen e rasteve të dhunës në familje, e poashtu edhe prokuror të specializuar për ndjekjen e rasteve të trafikimit me qenie njerëzore.
- **SHOQËRIA CIVILE** – Të vazhdoj të jap kontributin e saj në organizimin e fushatave për vetëdijësimin e popullatës për raportimin e dhunës në familje dhe informimin për infrastrukturën ligjore si dhe të monitoroj zbatimin e obligimeve qeveritare.
- **MEDIAT** – Të përcjellin zbatimin në praktikë të dy strategjive, të jenë prezente dhe të publikojnë çdo debat, tryezë apo aktivitete të ngjashëm lidhur me këto dukuri negative.
- **KOMUNAT E KOSOVËS** - gjegjësisht drejtoritë përkatëse: DKRS, DPMS, DKA dhe DSH, të organizojnë fushata për vetëdijësimin e qytetarëve për raportimin e dhunës në familje dhe rrezikut mbi trafikimin me qenie njerëzore, të ndaj më tepër buxhet për të përmirësuar infrastrukturën dhe siguruar staf kompetent në institucionet relevante. Të trajnohet stafi shëndetësor për trajtimin e viktimave të dhunës.
- **DKA** nëpër komuna, të përfshijë pedagogë dhe psikologë në të gjitha shkollat.

- **MSH** -Të krijohen ekipet e veçanta në kuadër të shërbimit mjekësor për trajtim të rasteve të dhunës në familje.
- **GJYQËSORI** - Të rritet numri i gjyqtarëve në gjykatat komunale dhe ato të qarkut.
- **MPMS** - Krijimi i hapësirave më relaksuese për intervistim në kuadër të QPS-ve.
- Të krijohet databaza e mirëfilltë me të dhëna të sakta mbi rastet e dhunës në familje dhe trafikimit me qenie njerëzore në Gjykata dhe Prokurori, QPS, Polici dhe Qendra të Mjekësisë Familjare. Pothuajse të gjitha këto institucione shënimet i mbajnë dhe i procesojnë në forma më klasike të evidentimit (me fletore ose program kompjuterik word ose excel).
- Të realizohen vlerësime dhe monitorime të strategjive çdo vit dhe raporti të shpërndahej tek institucionet (Gjykata, Policia, Komuna, QPS, QMKF etj.)
- Të rritet bashkëpunimi në mes institucioneve lokale dhe OJQ-ve,
- Përveq viktimës të kenë tretman psikosocial edhe anëtarët e tjerë të familjes, sidomos fëmijët.
- Të hapen këshillimore për viktimat dhe kryesit e dhunës.
- Aplikimi i masës së largimit nga shtëpia të kryesit të dhunës e jo të viktimës.
- Të mirret masa ligjore për prindërit e fëmijëve të mitur që braktisin shkollën.
- Të ketë koordinim më të mirë të aktiviteteve kur vie deri te mbivendosja e aktiviteteve nga dy apo më tepër objektiva.
- Ofrimi i asistencës sociale dhe mbështetjes së viktimave të trafikimit.
- Ofrimi i shërbimeve falas për viktimat e dhunës dhe trafikimit.

Shtojca nr. 1 Lista e institucioneve dhe personave të kontaktuar apo intervistuar për grumbullim të të dhënave për raportin e monitorimit:

KSK – Naime Sherifi, Drejtoreshë

Policia e Kosovës Gjakovë/Djakovica - Berlinda BERISHA, Mbikëqyrës i Hetimeve

Mbrojtës i viktimave Gjakovë/Djakovica - Agim PULA, Punëtorë sociale

"SHES" Gjakovë/Djakovica - Sakibe DOLI, Drejtoreshë

Gjykata Komunale Gjakovë/Djakovica - Adem ADEMAJ, Gjyqtar

Prokuria Komunale Gjakovë/Djakovica – Shpresa Bakija, Kryeprokurore

Qendra për Punë Sociale Gjakovë/Djakovica - Tahir Kida

Zyrta për barazi gjinore Gjakovë/Djakovica - Lumnije Shllaku

Gjykata Komunale Deçan/Deçane - Hakë Haxhaj

Mbrojtësi i viktimave Deçan/Deçane - Hakë Haxhaj

Policia e Kosovës Deçan/Deçane - Xhavit Nimani, Shef i hetimeve dhe Ruke Dobaj

Qendra për punë sociale Deçan/Deçane - Ibrahim Lushaj, Punëtor social

Qendra për pune sociale Junik/Junik - Florian Miroci, Punëtor social

Policia e Kosovës Junik/Junik - Behar Fetaj, Punonjës në Njësinë e Dhunës

Gjykata komunale në Prizren/Prizren - Administratori

Mbrojtësi i viktimave në Prizren/Prizren – Shemsa Sagdati dhe Ganimete Kitmiri

Drejtoria e Arsimit – Reshit Kushaj, Zyrtar (ka siguruar edhe të dhënat për Malishevë-Mališevo, Suharekë/Suva Reka, Dragash/Dragaš dhe Rahovec/Orahovac)

Drejtoria e Shëndetësisë në Prizren/Prizren - Nexhip Gashi, Drejtor

Drejtoria për Mirëqenje Sociale – Farije Bytyqi, Drejtoreshë (ka siguruar edhe të dhënat për Malishevë/Mališevo, Suharekë/Suva Reka, Dragash/Dragaš dhe Rahovec/Orahovac)

QPS Prizren/Prizren – Kumrije Krasniqi , Koordinatore

Policia e Kosovës në Prizren/Prizren - nuk kemi arritur të marrim të dhënat, sepse personi përgjegjës ishte në pushim

Strehimorja në Prizren/Prizren – nuk ka bashkëpunuar, nuk na ka ofruar të dhënat

Njësia për Ndihmë Juridike Falas – (ka siguruar edhe të dhënat për Malishevë/Mališevo, Suharekë/Suva Reka, Dragash/Dragaš dhe Rahovec/Orahovac)

Zyra për barazi Gjinore në Prizren/Prizren - Mybexhel Zhuri, Zyrtar për barazi gjinore

Policia e Kosovës në Podujevë/Podujevo – Shefi i divizioni kundër dhunës në familje

Gjykata komunale në Prishtinë/Priština – Kryetarja e gjykatës

Gjykata komunale në Lipjan/Lipljane – Gjykatëse

QPS Fushë Kosovë/Kosovo Polje – Zyrtar

ZBGJ Fushë Kosovë/Kosovo Polje – Zyrtarja për barazi gjinore

ZBGJ Podujevë/Podujevo – Zyrtarja për barazi gjinore

Policia e Kosovës Prishtinë/Priština - Tahire Haxholli, Udhëheqëse e Divizionit kundër DHF

Policia e Kosovës Prishtinë/Priština – Arben Paçarrizi, Udhëheqës Divizioni Anti-trafikim
 Policia e Kosovës Mitrovicë/Mitrovica - Rizah Murati, Njësia kundër Drogës
 Policia e Kosovës Mitrovicë/Mitrovica - Sabit Hajdari, Njësia kundër Dhunës në Familje
 Prokuroria e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica - Ismet Ujkani
 Gjykata Komunale në Mitrovicë/Mitrovica - Ramë Hyseni, Kryetar
 Gjykata e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica - Xhevdet Abazi, Kryetar i Gjykatës
 MV - Burhan Maxhuni, Mbrojtësi i Viktimave
 QPS Mitrovicë/Mitrovica - Fikrije Sylejmani,
 Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve Mitrovicë/Mitrovica - Emine Kabashi
 Komuna e Mitrovicës/Mitrovica - Fatbardha Boletini – Zyrtare për Informim
 Drejtoria Komunale e Shëndetësisë Mitrovicë/Mitrovica - Shaqir Demiri
 Drejtoria Komunale për Punë dhe Mirëqenje Sociale në Mitrovicë/Mitrovica - Faik Prekazi
 Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport Mitrovicë/Mitrovica- Artan Osmani
 ABGJ - Edi GUSIA , Zyrtare e lartë për Monitorim dhe Raportim
 Prokuroria e Shtetit - Shenaj BERISHA , Kordinatore e Mbrojtësve të viktimave
 Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale Klinë/Klina - Mujë GASHI , Drejtor
 Qendra e Mjekësisë Familjare Klinë/Klina - Qamile QITAKU, Kryeinfermiere
 Drejtoria e Arsimit Klinë/Klina - Ramiz RRUSTA , Drejtor
 Gjykata Komunale Klinë/Klina - Jashar GASHI, Kryetar
 Drejtoria për Kulturë Rini e Sport Klinë/Klina - Ahmet KRASNIQI , Drejtor
 Qendra për Punë Sociale Klinë/Klina - Shehrije MILLAKU, Punëtore sociale
 Policia e Kosovës Klinë/Klina - Zenel HALITAJ, Mbikëqyres i Hetimeve
 ZBGJ Klinë/Klina - Remzie MALOKU
 Radio ALBA Klinë/Klina - Shqipe DESKU, Gazetare
 Koha Ditore - Agron GASHI, Korrespondenti nga Klinë/Klina
 Drejtoria e shëndetësisë Istog/Istok - Anton GEGA , Drejtor
 Drejtoria e Arsimit Istog/Istok - Agim HAXHIA, Drejtor
 Gjykata Komunale Istog/Istok - Ramadan SHATRI, Kryetar
 Policia e Kosovës Istog/Istok - Selvete BLAKAJ, Police Hetuese
 Qendra për Punë Sociale Istog/Istok - Haki Ibrahimaj, Drejtor
 ZBGJ Istog/Istok - Sanije MAVRAJ
 Policia e Kosovës Pejë/Peć - Violeta Demë HASA, Hetuese Regjionale për dhunë në familje
 Policia e Kosovës Pejë/Peć - Idriz ATASHI, Mbikëqyres i Njësitit kundër trafikimit me Qenie Njerëzore
 Qendra për Punë Sociale Pejë/Peć - Drita Kelmendi KUKAJ, Drejtoreshë
 ZBGJ Pejë/Peć - Sebahate QORKADIU
 QMG"SHS" Pejë/Peć - Resmije TAHIRI, Kordinatore
 Prokuroria Komunale Pejë/Peć - Lirije Morina, Ushtrues detyre
 KGJK – Aishe Qorraj, Zyrtare për informim
 KGJK – Besnik Ramsaj, Drejtor i Departamentit të Statistikës

MSH – Zyrtari për informim

MASHT - Zyrtari për informim

MD- Zyrtari për informim

CLARD – Anton Ndrecaj

RTK - Redaktor

KTV - Redaktor

Radio Blu Sky- Redaktor

Disa nga institucionet tjera të kontaktuara:

ZBGJ në: Skenderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Gjilan/Gnjilane, Ferizaj/Uroševac, Kamenicë/Kamenica, Viti/Vitina.

MV në: Skënderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Gjilan/Gnjilane, Ferizaj/Uroševac, Kamenicë/Kamenica, Viti/Vitina, Kaçanik/Kaçanik, Shtërpce/Štrpce.

Strehimorja në Gjilan/Gnjilane, Prishtinë/Priština.

Policia e Kosovës në: Skënderaj/Srbica, Vushtrri/Vučitrn, Gjilan/Gnjilane, Ferizaj/Uroševac, Kamenicë/Kamenica, Viti/Vitina, Kaçanik/Kaçanik, Shtërpce/Štrpce, Obiliq/Obilić, Klllokot/Klokot, Ranillug/Ranilug, Novo Bërdë/NovoBrdo.

Gjykata Komunale: Viti/Vitina, Kamenicë/Kamenica, Rahovec/Orahovac, Suharekë/Suva Reka.

Gjykata e Qarkut në: Gjilan/Gnjilane, Prishtinë/Priština, etj.

Shtojca nr. 2: Plani i Veprimit SNKTQNJ 2011-2014

Treguesit e monitorimit të aktiviteteve të realizuara gjatë vitit 2011

1. Parandalimi

Synimi strategjik 1: Të ngritet vetëdijesimi i publikut mbi çështjet e trafikimit me qenie njerëzore

Objektivi Specifik 1.1 – Të vetëdijesohen grupet e rrezikuara dhe ato të interesit (fëmijëve, të rinjve, gra, burra) për çështjet e trafikimit.

	Aktivitetet	Afatet kohore	Buxheti	Përgjegjësit	Partnerët	Treguesit e monitorimit
1.1.1	Realizimi i hulumtimeve të thelluara/detajuara për vlerësimin e nivelit të vetëdijesimit, lidhur me trafikimin me qenie njerëzore.	2011-2014	24000	KNKT/ GNKT MPB; PK; MKRS; ABGJ,	ON, OJQ, KE	E pa realizuar
1.1.2	Realizimi i një vrojtimi (hulumtimi) në zonat urbane dhe rurale, mbi nivelin e ndërgjegjësimit të popullatës si rezultat i fushatës së realizuar gjatë vitit paraprak.	2011-2014		KNKT/ GNKT MPB; PK; MKRS; ABGJ,	ON, OJQ, KE	E pa realizuar
1.1.3	Organizimi i fushatave sensibilizuese në media (debate, tryeza, spote televizive, materiale senzibilizuese, aktivitetet artistike, aktivitete shkollore, etj) në periudha të ndryshme kohore.	2011-2014 Gjatë vitit dhe në kuadër të muajit antitrafikim.	120.000	KNKT MPB; MKRS; MASHT; MD; MSH, PK; ABGJ MTI.	ON,OJQ	Pjesërisht e realizuar
1.1.4	Shqyrtimi i materialeve ekzistuese (doracakëve lehtësues dhe informativ), përgatitja e materialeve të reja dhe shpërndarja e tyre të gjitha kategoritë dhe strukturat shoqërore.	2011-2014	8000	KNKT MPB; PK; MPAL; MASHT, Institucione të specializuara.	ON, OJQ	Pjesërisht e realizuar

Objektivi specifik 1.2 - Të vetëdijësohet publiku i gjerë, lidhur me sanksionet ligjore për trafikimin me qenie njerëzore.						
	Aktivitetet	Afatet kohore	Buxheti	Përgjegjësit	Partnerët	Treguesit e monitorimit
1.2.1	Fushata vetëdijësuese lidhur me sanksionet ligjore për persona që kryejnë veprime ilegale të trafikimit me qenie njerëzore apo cilëndo formë të shfytëzimit.	2011-2014	8000	KNKT,MPB MD, PK, KGJ,		E pa realizuar nga organet kompetente ndërsa nga Donatorët dhe OJQ –të lokale ka pas disa fushata vetëdijësuese
Synimi strategjik 2 - Të shtohet efikasiteti i parandalimit të trafikimit në të gjitha nivelet e arsimit.						
Objektivi specifik 2.1- Të plotësohen kurrikulat edukativo-arsimore me informacionet e duhura për parandalimin e trafikimit.						
	Aktivitetet	Afatet kohore	Buxheti	Përgjegjësit	Partnerët	Treguesit e monitorimit
2.1.1	Sesione informuese me grupin e kurrikulave për çështjen e trafikimit, me qëllim të parandalimit.	2011	400	MASHT; GNKT		E realizuar pjesërisht
2.1.2	Pajisja e institucioneve arsimore (të të gjitha niveleve, përfshirë dhe ato parashkollore), mësimdhënësve, nxënësve, studentëve me materiale didaktiko-metodike për çështjen antitrafikim.	2012-2014	20000	MASHT MPB; MKRS;	OJQ,ON	Pa të dhëna
2.1.3	Aftësimi i mësimdhënësve për përdorimin e materialeve didaktiko-metodike.	2012-2014	10000	MASHT	OJQ,ON.	Pa të dhëna
Objektivi specifik 2.2 Të rritet përfshirja e grupeve të rrezikuara në arsimim joformal.						
	Aktivitetet	Afatet kohore	Buxheti	Përgjegjësit	Partnerët	Treguesit e monitorimit
2.2.1	Organizimi i formave alternative të mësimi për grupet e rrezikuara.	2011-2014		MASHT; DKA; Komunitat	OJQ,ON.	E përealizuar, nuk ka shënime nga aktorët kompetent a është bërë diçka në këtë drejtim.

2.2.2	Organizimi i kurseve të aftësimit profesional për mundësi punësimi.	2011-2014		MASHT; MPMS; MAPL	OJQ,ON.	E realizuar pjesërisht, mirëpo nuk kemi pranuar statistika nga akterët kyq.
Objektivi specifik 2.3 Të trajtohet me efikasitet problemi i braktisjes së shkollës nga nxënësit.						
	Aktivitetet	Afatet kohore	Buxheti	Përgjegjësit	Partnerët	Treguesit e monitorimit
2.3.1	Nxerrja e urdhërit administrativ për krijimin e ekipeve për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes së shkollës nga nxënësit (EPRBSHN).	2011		MASHT	OJQ,ON	E përealizuar
2.3.2	Krijimi i EPRBSHN në nivel shkolle dhe komune.	2011-2012		MASHT DKA	DKA	Pa të dhëna
2.3.3	Trajnimi i EPRBSHN dhe ofrimi i materialeve të punës.	2012-2013	8000	MASHT, DKA	DKA	E përealizuar
Synimi strategjik 3- Të ngriten kapacitetet e burimeve njerëzore në parandalim e trafikimit dhe bashkëpunimi ndërinstitucional						
Objektivi specifik 3.1 Të zhvillohen dhe avancohen kapacitetet e institucioneve shtetërore në parandalimin e trafikimit.						
	Aktivitetet	Afatet kohore	Buxheti	Përgjegjësit	Partnerët	Treguesit e monitorimit
3.1.1	Organizimi i trajnimeve për zyrtarët komunal (për NJDNJK, DKA, DSH, DKRS, DPMS, për Inspektorët e punës, tregut dhe ata sanitarë, punëtorët socialë, policinë e komunitetit, etj.)	2011-2014	20.000	MPB, GNKT MAPL, IKAP, MASHT	ON,OJQ	E realizuar pjesërisht, mirëpo nuk kemi të dhëna për numrin e saktë të përfituesve
3.1.2	Organizimi i trajnimeve për zyrtarët e institucioneve të nivelit qendror.	2011-2012		MPB,GNKT	IKAP; ON,OJQ.	E realizuar pjesërisht, mirëpo nuk kemi të dhëna për numrin e saktë të përfituesve
Objektivi specifik 3.2 Të ngriten kapacitetet e institucioneve arsimore në parandalim të trafikimit.						

	Aktivitetet	Afatet kohore	Buxheti	Përgjegjësit	Partnerët	Treguesit e monitorimit
3.2.1	Organizimi i trajnimeve për strukturat organizative të nxënësve brenda shkollave.	2011-2014	6000	MASHT, MPB, GNKT, MSH, MD	ON,OJQ.	E pa realizuar
3.2.2	Organizimi i trajnimeve për mësimdhënës të të gjitha niveleve të arsimit parauniversitar dhe organeve të shkollës për çështjet antitrafikim.	2011-2014	8000	MASHT, MPB, GNKT, MSH, MD	ON,OJQ.	E realizuar pjesërisht, mirëpo nuk kemi të dhëna për numrin e saktë të përfituesve
3.2.3	Trajnime dhe sesione informuese me mësimdhënësit e fakulteteve të UP-së që përgatisin kuadro arsimore.	2011-2014	2000	MASHT, GNKT	ON,OJQ.	Pa të dhëna
Objektivi specifik 3.3 - Të ngriten kapacitetet e OJQ-ve dhe grupeve joformale në parandalimin e trafikimit.						
	Aktivitetet	Afatet kohore	Buxheti	Përgjegjësit	Partnerët	Treguesit e monitorimit
3.3.1	Organizimi i aktiviteteve për ngritjen e kapaciteteve të OJQ dhe grupeve joformale për punën në parandalim të trafikimit.	2011-2014	10000	KNKT, MKRS	OJQ ON,	E realizuar pjesërisht, mirëpo nuk kemi të dhëna për numrin e saktë të përfituesve
3.3.2	Organizimi i “Javes Kombëtare së të drejtave të viktimave të krimit” në tri qytete kryesore në përkujtim të viktimave të trafikimit dhe krimeve të tjera	2011-2014	12000	KPK, KNKT, MD, MPMS, PK	OJQ	E realizuar por pa të dhëna të sakta
3.3.3	Përmirësimi dhe funksionalizimi i faqes së internetit ëëë.antitrafikimi.com në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe për të rritur transparencën ndaj publikut në Kosovë.	2011-2014	4500	KNKT, MAP	OJQ, ON	Faqja e internetit e përmirësuar (updated)
Objektivi specifik 3.4 - Të forcohet bashkëpunimi ndërinstitutional si dhe bashkëpunimi me komunitetin në parandalimin e trafikimit						

	Aktivitetet	Afatet kohore	Buxheti	Përgjegjësit	Partnerët	Treguesit e monitorimit
3.4.1	Takimet e rregullta të GNKT me qëllim të shkëmbimit të informacioneve dhe të koordinimit të aktiviteteve në luftim të trafikimit.	2011-2014		KNKT, GNKT	Pa të dhëna	Pa të dhëna
3.4.2	Forcimi i efikasitetit të punës me shtimin e numrit të personalit në anti-TIP sekretariat.	2011		KNKT	ON.	Pa të dhëna
3.4.3	Takime informuese me komunitetin për mënyrën e adresimit rreth çështjeve për parandalimin e trafikimit me qenie njerëzore (ku dhe kujt duhet t'i raportohet, t'i kërkohet ndihmë, si të veprohet në rastet e identifikimit të trafikimit etj).	2011-2014		KNKT, GNKT	OJQ, ON	Pa të dhëna

2 Mbrojtja

Synimi strategjik 1 - Përmirësimi i Referimit dhe Identifikimit të viktimave të trafikimit me qenie njerzore

Objektivi specifik 1.1 - Avancimi i procedurave ekzistuese të referimit dhe identifikimit për viktimat e trafikimit

	Aktivitetet	Afati kohor	Buxheti	Përgjegjësit	Partnerët	Treguesit
1.1.1	Rishqyrtimi i Procedurave Standarte të Veprimit (PSV), dhe Standarteve Minimale të Përkujdesit për Viktimat e Trafikimit (SMPVT), ekzistuese, si edhe nxjerrja e rekomandimeve për ndryshime.	2011-2014		KNKT, MPB, MD, MPMS MSH,	OJQ, ON, OSBE, IOM,	E realizuar pjesërisht
1.1.2.	Organizimi i sesioneve informative për procedurat ekzistuese. (PSV dhe SMPVT).	2011		KNKT, MPB, MD, MPMS MSH,	OJQ, ON, OSBE.	Pa të dhëna
1.1.3.	Monitorimi dhe vlerësimi i implementimit të PSV dhe SMPVT.	2011 – 2014	2000	KNKT, Sekretariati,		Pa të dhëna
1.1.4	Trajnimi i akterëve relevant që përdorin PSV.	2011		KNKT, Sekretariati,		Pa të dhëna

